

# PËRTEJ PËRKUFIZIMEVE

Thirrje për veprim kundër  
gjuhës së urrejtjes në Shqipëri

**Botimi i 2-të**



Bashkëfinancuar nga  
Bashkimi Evropian



BASHKIMI EVROPIAN

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Bashkëfinancuar dhe zbatuar  
nga Këshilli i Evropës

# PËRTEJ PËRKUFIZIMEVE

Thirrje për veprim kundër  
gjuhës së urrejtjes në Shqipëri

**Botimi i 2-të**

Ky botim u përgatit me mbështetjen financiare të Bashkimit European dhe të Këshillit të Europës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit(ëve). Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit European ose të Këshillit të Europës.

Autorizohet riprodhimi i ekstrakteve (deri në 500 fjalë), përveçse për qëllime tregtare për sa kohë që ruhet integriteti i tekstit, fragmenti nuk përdoret jashtë kontekstit, nuk jepet informacion i paplotë ose përndryshe lexuesi nuk keqorientohet për natyrën, qëllimin ose përmbajtjen e tekstit. Teksti burimor duhet të njihet gjithmonë si vijon "© Këshilli i Europës, 2025". Të gjitha kërkesat e tjera në lidhje me riprodhimin/përkthimin e të gjithë ose një pjese të dokumentit, duhet t'i drejtohen Drejtorisë së Komunikimeve, Këshilli i Europës (F67075 - Strasbourg Cedex ose [publishing@coe.int](mailto:publishing@coe.int)).

Të gjitha korrespondencat e tjera në lidhje me këtë dokument duhet t'i drejtohen Drejtorisë së Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të Ligjit/Njësia për Europën Juglindore dhe Turqinë, Avenue de l'Europe F67075- Strasbourg Cedex, France, Tel. (0)3 88 41 20 00 +33, E-mail: [Horizontal.Facility@coe.int](mailto:Horizontal.Facility@coe.int)

© Këshilli i Europës, Dhjetor 2025.  
Të gjitha të drejtat e rezervuara. Licencuar për Bashkimin European sipas kushteve.

Kopertina: The freepick

# Përmbajtja

<b>1. PËRMBLEDHJE E STUDIMIT TË KRYER NË 2024</b>	<b>9</b>
Rekomandime në lidhje me gjuhën e urrejtjes në Shqipëri	17
<b>2. METODOLOGJIA E STUDIMIT</b>	<b>19</b>
2.1 Shpërndarja e mostrës	19
2.2 Konceptimi i instrumentit të anketës	20
2.3 Analizimi i të dhënave	20
2.4 Përzgjedhja e pjesëmarrësve të anketës	20
2.5 Etika	20
2.5.1 Pëlqimi i informuar për pjesëmarrësit e anketës	20
2.5.2 Privatësia dhe konfidencialiteti	20
<b>3. GJETJET KRYESORE</b>	<b>22</b>
3.1 Profili i popullatës së anketuar	22
3.1.1 Profili i mostrës shtesë	24
3.2 Njohuria për "gjuhën e urrejtjes"	24
2.1 Njohuria për gjuhën e urrejtjes mes mostrës shtesë	26
3.3 Perceptime për gjuhën e urrejtjes	27
3.4 Perceptime për gjuhën e urrejtjes nga komuniteti LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian	37
3.5 Përvoja me gjuhën e urrejtjes	39
3.6 Niveli i ndërgjegjësimit dhe besimit në institucione	45
3.7 Niveli i ndërgjegjësimit dhe besimit në institucione mes mostrës shtesë	51
<b>4. LISTA E ANEKSEVE</b>	<b>55</b>
4.1 Fjalorth	55
4.2 Aneksi II: Pyetësor	57
4.3 ANEKSI III: Metodologjia CAWI	65
4.4 ANEKSI IV: Metodologjia CATI	66
4.5 Aneksi V: Listë e tabelave të mostrës kryesore	67
4.6 Aneksi III: Listë e tabelave të mostrës shtesë	78

# Lista e Figurave

---

Figura 1. Metodologjia për mbledhjen e të dhënave.....	19
Figura 2. Shpërndarja e mostrës për çdo qark.....	19
Figura 3. Të anketuarit sipas seksit. Publiku i gjerë.....	22
Figura 4. Të anketuarit sipas vendndodhjes urbane-rurale. Publiku i gjerë.....	23
Figura 5. Të anketuarit sipas qarkut. Publiku i gjerë.....	23
Figura 6. Të anketuarit sipas grupmoshës.....	23
Figura 7. Të anketuarit sipas nivelit arsimor. Publiku i gjerë.....	23
Figura 8. Të anketuarit sipas statusit të punësimit. Publiku i gjerë.....	23
Figura 9. A e dini çfarë është gjuha e urrejtjes? Publiku i gjerë.....	24
Figura 10. A e dini çfarë është gjuha e urrejtjes? Publiku i gjerë.....	25
Figura 11. Njohuria për gjuhën e urrejtjes mes mostrës shtesë.....	26
Figura 12. Të anketuarit nga mostra shtesë që u përgjigjën “po”: Çfarë kuptojnë ata me termin “gjuha e urrejtjes”.....	27
Figura 13. Për mendimin tuaj, sa e përhapur është gjuha e urrejtjes në Shqipëri? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë.....	27
Figura 14. Për mendimin tuaj, sa e përhapur është gjuha e urrejtjes në Shqipëri Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas moshës.....	28
Figura 15. Për mendimin tuaj, cilat programe televizive (nëse ka) kanë më shumë gjasa të përhapin Gjuhën e Urrejtjes te ndjekësit e tyre? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë.....	28
Figura 16. Për mendimin tuaj, cilat programe televizive (nëse ka) kanë më shumë gjasa të përhapin Gjuhën e Urrejtjes te ndjekësit e tyre? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas seksit.....	29
Figura 17. Për mendimin tuaj, cilat programe televizive (nëse ka) kanë më shumë gjasa të përhapin Gjuhën e Urrejtjes te ndjekësit e tyre? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas moshës.....	29
Figura 18. Për mendimin tuaj, cilat programe televizive (nëse ka) kanë më shumë gjasa të përhapin Gjuhën e Urrejtjes te ndjekësit e tyre? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas vendndodhjes urbane-rurale.....	30
Figura 19. Për mendimin tuaj, cili është motivi më i zakonshëm që shkakton Gjuhën e Urrejtjes. Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë.....	30
Figura 20. Perceptimet e të anketuarve për shkaqet më të zakonshme që motivojnë gjuhën e urrejtjes, sipas seksit.....	31
Figura 21. Për mendimin tuaj, cili është motivi më i zakonshëm që shkakton Gjuhën e Urrejtjes sipas grupmoshës dhe vendndodhjes urbane-rurale. Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë.....	32

Figura 22. Për mendimin tuaj, cila formë e mëposhtme e të shprehurit mund të etiketohet si Gjuhë e Urrejtjes. Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë .....	33
Figura 23. Për mendimin tuaj, cila formë e mëposhtme e të shprehurit mund të etiketohet si Gjuhë e Urrejtjes. Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas moshës.....	34
Figura 24 Për mendimin tuaj, cila formë e mëposhtme e të shprehurit mund të etiketohet si Gjuhë e Urrejtjes. Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas vendndodhjes urbane-rurale.....	34
Figura 25. Cilat nga sa më poshtë mund të përjetojë një person/grup që është objekt i gjuhës së urrejtjes. Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas seksit.....	35
Figura 26. Cilat nga sa më poshtë mund të përjetojë një person/grup që është objekt i gjuhës së urrejtjes. Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas grupmoshës.....	35
Figura 27. Ku/në cilin kontekst mund të përjetojë më shumë Gjuha e Urrejtjes në Shqipëri? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë.....	36
Figura 28. Ku/në cilin kontekst mund të përjetojë më shumë Gjuha e Urrejtjes në Shqipëri? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas grupmoshës.....	36
Figura 29. Për mendimin tuaj, sa e përhapur është gjuha e urrejtjes në Shqipëri? Përgjigje të mostrës shtesë nga komunitetet LGBTI++ dhe Rom/Egjiptian .....	37
Figura 30. Cilat programe televizive ka më shumë gjasa të përhapin Gjuhën e Urrejtjes? Përgjigje të mostrës shtesë nga komunitetet LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian .....	37
Figura 31. Cili është motivi më i zakonshëm që shkakton Gjuhën e Urrejtjes? Përgjigje të mostrës shtesë nga komunitetet LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian .....	38
Figura 32. Cilat forma të mëposhtme të të shprehurit mund të etiketohen si Gjuhë e Urrejtjes? .....	38
Figura 33. Cilat nga emocionet e mëposhtme mund të përjetojë një person/grup që është objekt i gjuhës së urrejtjes? Përgjigje të mostrës shtesë nga komunitetet LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian .....	39
Figura 34. A keni dëgjuar ose a jeni ekspozuar ju personalisht apo persona të tjerë së fundmi me Gjuhën e Urrejtjes? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë .....	39
Figura 35. A keni qenë ju personalisht apo a keni dëgjuar për persona të tjerë së fundmi që kanë qenë të ekspozuar me Gjuhën e Urrejtjes? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas grupmoshës .....	40
Figura 36. Në rast se keni qenë dëshmitar i gjuhës së urrejtjes të përdorur ndaj dikujt tjetër, a keni marrë ndonjë masë? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë.....	40
Figura 37. Në rast se keni qenë dëshmitar i gjuhës së urrejtjes të përdorur ndaj dikujt tjetër, a keni marrë ndonjë masë? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas grupmoshës.....	40
Figura 38. A keni qenë ndonjëherë të ekspozuar ndaj Gjuhës së Urrejtjes në internet? Publiku i gjerë .....	41
Figura 39. A keni qenë ndonjëherë të ekspozuar ndaj Gjuhës së Urrejtjes në internet? sipas grupmoshës. Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë.....	41
Figura 40. Në rast se keni qenë të ekspozuar ndaj gjuhës së urrejtjes në internet, çfarë keni bërë? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë.....	42
Figura 41. Në rast se keni qenë të ekspozuar ndaj gjuhës së urrejtjes në internet, çfarë keni bërë? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas gjinisë.....	42
Figura 42. A keni dëgjuar ose a jeni ekspozuar ju personalisht apo persona të tjerë së fundmi me Gjuhën e Urrejtjes? Përgjigje të mostrës shtesë nga komunitetet LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian .....	43
Figura 43. A keni dëgjuar ose a jeni ekspozuar ju personalisht apo persona të tjerë së fundmi me Gjuhën e Urrejtjes? Përgjigje të mostrës shtesë nga komunitetet LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian.....	43
Figura 44. Në rast se keni qenë dëshmitar i gjuhës së urrejtjes të përdorur ndaj dikujt tjetër, a keni marrë ndonjë masë? Përgjigje të mostrës shtesë nga komunitetet LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian .....	43

Figura 45. A keni qenë ndonjëherë të ekspozuar ndaj Gjuhës së Urrejtjes në internet? Përgjigje të mostrës shtesë nga komunitetet LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian .....	44
Figura 46. Në rast se keni qenë të ekspozuar ndaj gjuhës së urrejtjes në internet, çfarë keni bërë? Përgjigje të mostrës shtesë nga komunitetet LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian .....	45
Figura 47. A keni dijeni për ndonjë ligj që mbron njerëzit nga Gjuha e Urrejtjes? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë.....	45
Figura 48. A keni dijeni për ndonjë ligj që mbron njerëzit nga Gjuha e Urrejtjes? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas grupmoshës.....	46
Figura 49. Nëse do të ishit objekt i gjuhës së urrejtjes, ku do të shkonit për të kërkuar ndihmë? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë.....	46
Figura 50. Nëse do të ishit objekt i gjuhës së urrejtjes, ku do të shkonit për të kërkuar ndihmë? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas seksit.....	47
Figura 51. Nëse do të ishit objekt i gjuhës së urrejtjes, ku do të shkonit për të kërkuar ndihmë? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas seksit.....	47
Figura 52. Mund të shpjegoni pse? (vetëm ata që nuk do të shkonin të kërkonin ndihmë). Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas seksit.....	48
Figura 53. Për mendimin tuaj, cilat janë institucionet më të përkushtuara për të luftuar gjuhën e urrejtjes në Shqipëri. Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë .....	49
Figura 54. Për mendimin tuaj, cilat janë institucionet më të përkushtuara për të luftuar gjuhën e urrejtjes në Shqipëri. Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas seksit.....	50
Figura 55 Për mendimin tuaj, si ka ndryshuar shpeshtia e gjuhës së urrejtjes në forume publike (p.sh., media sociale, lajme) gjatë pesë viteve të fundit? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë.....	50
Figura 56. Si ndiheni për efektshmërinë e masave aktuale (p.sh., udhëzime të komunitetit, ligje) për uljen e gjuhës së urrejtjes krahasuar me disa vite më parë? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë.....	51
Figura 57. A keni dijeni për ndonjë ligj që mbron njerëzit nga Gjuha e Urrejtjes? Përgjigje të mostrës shtesë nga komunitetet LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian .....	51
Figura 58. Nëse do të ishit objekt i gjuhës së urrejtjes, ku do të shkonit për të kërkuar ndihmë? Përgjigje të mostrës shtesë nga komunitetet LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian .....	52
Figura 59. Mund të shpjegoni pse? (vetëm ata që nuk do të shkonin të kërkonin ndihmë) Përgjigje të mostrës shtesë nga komunitetet LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian .....	52
Figura 60. Për mendimin tuaj, cilat janë institucionet më të përkushtuara për të luftuar gjuhën e urrejtjes në Shqipëri? Përgjigje të mostrës shtesë nga komunitetet LGBT+ dhe Rom/Egjiptian .....	53
Figura 61. Për mendimin tuaj si ka ndryshuar shpeshtia e gjuhës së urrejtjes në forume publike .....	54
Figura 62. Si ndiheni për efektshmërinë e masave aktuale .....	54

# List of Tables

---

Tabela 1. Kategoritë kryesore dhe shkaqet për gjuhën e urrejtjes në përgjigje të pyetjes se çfarë është gjuha e urrejtjes të bërë në anketën e publikut të gjerë .....	25
Tabela A. 1. Të anketuarit sipas seksit.....	67
Tabela A. 2. Të anketuarit sipas grupmoshës.....	67
Tabela A. 3. Të anketuarit sipas nivelit arsimor të përfunduar .....	68
Tabela A. 4. Të anketuarit sipas zonës .....	68
Tabela A. 5. Të anketuarit sipas punësimit.....	68
Tabela A. 6. Të anketuarit sipas qarkut.....	68
Tabela A. 7. Të anketuarit sipas Fesë.....	68
Tabela A. 8. Të anketuarit sipas moshës mesatare dhe mediane .....	69
Tabela A. 9. A e dini çfarë është gjuha e urrejtjes? .....	69
Tabela A. 10. A e dini çfarë është gjuha e urrejtjes?.....	69
Tabela A. 11. A e dini çfarë është gjuha ofenduese/diskriminuese?.....	69
Tabela A. 12. Nëse jeni përgjigjur “po” për pyetjen paraprake, a mund të shpjegoni shkurtimisht se çfarë do të thotë kjo për ju?.....	69
Tabela A. 13. Për mendimin tuaj, sa e përhapur është gjuha e urrejtjes në Shqipëri? .....	70
Tabela A. 14. Cili është motivi më i zakonshëm që shkakton Gjuhën e Urrejtjes?.....	71
Tabela A. 15. Ku/në cilin kontekst mund të përjetohet më shumë Gjuha e Urrejtjes në Shqipëri?.....	71
Tabela A. 16. Cilat programe televizive (nëse ka) kanë më shumë gjasa të përhapin Gjuhën e Urrejtjes te ndjekësit e tyre?.....	72
Tabela A. 17. Cilat forma të mëposhtme të të shprehurit mund të etiketohen si Gjuhë e Urrejtjes? .....	72
Tabela A. 18. A keni dëgjuar ose a jeni ekspozuar ju personalisht apo persona të tjerë së fundmi me Gjuhën e Urrejtjes?.....	73
Tabela A. 19. A mund të na jepni një shembull të gjuhës së urrejtjes që keni dëgjuar apo me të cilën jeni ekspozuar kohët e fundit?.....	73
Tabela A. 20. Cilat janë institucionet më të përkushtuara për të luftuar gjuhën e urrejtjes në Shqipëri?.....	74
Tabela A. 21. A keni dijeni për ndonjë ligj që mbron njerëzit nga Gjuha e Urrejtjes? .....	75
Tabela A. 22. Nëse do të ishit objekt i gjuhës së urrejtjes, ku do të shkonit për të kërkuar ndihmë? .....	75
Tabela A. 23. Nëse jeni përgjigjur në pikën 13 të pyetjes paraprake, a mund të na shpjegoni pse? .....	75
Tabela A. 24. A keni qenë ndonjëherë të ekspozuar ndaj Gjuhës së Urrejtjes në internet? .....	76
Tabela A. 25. Në rast se keni qenë të ekspozuar ndaj gjuhës së urrejtjes në internet, çfarë keni bërë?.....	76
Tabela A. 26. Në rast se keni qenë dëshmitar i gjuhës së urrejtjes të përdorur ndaj dikujt tjetër, a keni marrë	

ndonjë masë?.....	77
Tabela A. 27. Cilat nga sa më poshtë mund të përjetojë një person/grup që është objekt i gjuhës së urrejtjes:.....	77
Tabela A. 28. Për mendimin tuaj si ka ndryshuar shpeshësia e gjuhës së urrejtjes në forume publike (p.sh media sociale,lajme) gjatë pesë viteve të fundit? .....	78
Tabela A. 29. Si ndiheni për efektshmërinë e masave aktuale (p.sh., udhëzime të komunitetit, ligje) për uljen e gjuhës së urrejtjes krahasuar me disa vite më parë?.....	78
Tabela B. 1. Të anketuarit sipas seksit, mostra shtesë .....	78
Tabela B. 2. Të anketuarit sipas grupmoshës, mostra shtesë .....	79
Tabela B. 3. Të anketuarit sipas fesë, mostra shtesë .....	79
Tabela B. 4. Të anketuarit sipas nivelit arsimor, mostra shtesë.....	79
Tabela B. 5. Të anketuarit sipas statusit të punësimit, mostra shtesë .....	79
Tabela B. 6. Shpërndarja e popullsisë sipas cënueshmërisë, mostra shtesë .....	79
Tabela B. 7. A e dini çfarë është gjuha e urrejtjes, mostra shtesë.....	80
Tabela B. 8. Kategoritë kryesore për pyetjen se çfarë është gjuha e urrejtjes, mostra shtesë .....	80
Tabela B. 9. Për mendimin tuaj, sa e përhapur është gjuha e urrejtjes në Shqipëri? mostra shtesë .....	80
Tabela B. 10. Cilat programe televizive (nëse ka) kanë më shumë gjasa të përhapin Gjuhën e Urrejtjes te ndjekësit e tyre? mostra shtesë.....	80
Tabela B. 11. Cili është motivi më i zakonshëm që shkakton Gjuhën e Urrejtjes? mostra shtesë .....	81
Tabela B. 12. Cilat forma të mëposhtme të të shprehurit mund të etiketohen si Gjuhë e Urrejtjes? mostra shtesë.....	81
Tabela B. 13. Cilat nga sa më poshtë mund të përjetojë një person/grup që është objekt i gjuhës së urrejtjes:.....	82
Tabela B. 14. Ku/në cilin kontekst mund të përjetohet më shumë Gjuha e Urrejtjes në Shqipëri? mostra shtesë.....	82
Tabela B. 15. A keni dëgjuar ose a jeni ekspozuar ju personalisht apo persona të tjerë së fundmi me gjuhën e urrejtjes? mostra shtesë.....	82
Tabela B. 16. Në rast se keni qenë dëshmitar i gjuhës së urrejtjes të përdorur ndaj dikujt tjetër, a keni marrë ndonjë masë? mostra shtesë.....	83
Tabela B. 17. A keni qenë ndonjëherë të ekspozuar ndaj Gjuhës së Urrejtjes në internet? mostra shtesë.....	83
Tabela B. 18. Në rast se keni qenë të ekspozuar ndaj gjuhës së urrejtjes në internet, çfarë keni bërë? mostra shtesë.....	83
Tabela B. 19. A keni dijeni për ndonjë ligj që mbron njerëzit nga Gjuha e Urrejtjes? mostra shtesë.....	83
Tabela B. 20. Nëse do të ishit objekt i gjuhës së urrejtjes, ku do të shkonit për të kërkuar ndihmë? mostra shtesë.....	83
Tabela B. 21. Nëse jeni përgjigjur në pikën 13 të pyetjes paraprake, a mund të na shpjegoni pse? mostra shtesë .....	84
Tabela B. 22. Cilat janë institucionet më të përkushtuara për të luftuar Gjuhën e Urrejtjes në Shqipëri? mostra shtesë.....	84
Tabela B. 23. Për mendimin tuaj, si ka ndryshuar shpeshësia e gjuhës së urrejtjes në forume publike (p.sh., media sociale, lajme) gjatë pesë viteve të fundit? mostra shtesë.....	85
Tabela B. 24. Si ndiheni për efektshmërinë e masave aktuale (p.sh., udhëzime komuniteti, ligje) në uljen e gjuhës së urrejtjes krahasuar me disa vite më parë? mostra shtesë .....	85

# 1. Përmbledhja e studimit të kryer në 2024

Qëllimi i këtij raporti është të paraqesë të dhëna në nivel kombëtar mbi situatën e gjuhës së urrejtjes në Shqipëri. Edhe pse terminologjia dhe fenomeni janë relativisht të reja në vend, gjuha e urrejtjes mbetet shqetësuese si mes popullatës së përgjithshme ashtu edhe mes grupeve që janë objekt i gjuhës së urrejtjes.

Raporti jep njohuri mbi perceptimet, përvojat dhe besimin në institucionet përgjegjëse për adresimin e gjuhës së urrejtjes në përpjekje për të mbushur boshllëkun e informacionit mbi mënyrën se si perceptohet kjo çështje nga individët. Studimi përfshin një mostër prej 1,000 pjesëmarrësish të përzgjedhur rastësisht, të plotësuar me një mostër shtesë me 213 të anketuar, një grup shtesë i përzgjedhur qëllimisht nga komunitetet LGBTI+ dhe romë/egjiptiane për të siguruar përfaqësim të mjaftueshëm të popullatave të ekspozuara më shpesh ndaj gjuhës së urrejtjes.

## PERCEPTIME PËR GJUHËN E URREJTJES

- Ndërgjegjësimi:** Rreth 72% e publikut të gjerë e pranon që gjuha e urrejtjes ekziston, ndërkohë që shumë prej tyre vlerësojnë se është rritur në pesë vitet e fundit. Ndërgjegjësimi për ligjet specifike është i ndryshëm dhe shqetësimet në lidhje me ndikimin e gjuhës së urrejtjes në shoqëri janë të përhapura. Komuniteti LGBTI+ tregon ndërgjegjësim më të lartë (84%) krahasuar me komunitetin rom/egjiptian (47%), duke reflektuar ndryshimet që lidhen edhe me dallimet në qasjen në arsim dhe kushtet socio-ekonomike. Shumica e të anketuarve e lidhin gjuhën e urrejtjes me ofendimin e dikujt duke përdorur gjuhë përcmuese.
- Kanalet:** Media, sidomos programet e realitetit dhe debatet, identifikohen si kanale të rëndësishme për përhapjen e gjuhës së urrejtjes. Publiku i gjerë është gjithnjë e më i vetëdijshëm për rolin e medias sociale (64%). Individët LGBTI+ tregojnë konkretisht programet e realitetit (92%), ndërsa të anketuarit romë theksojnë debatet e përgjithshme (51%).
- Shkaktarët:** Sipas të anketuarve LGBTI+ (82%) frika dhe fobia janë shkaktarët kryesorë të gjuhës së urrejtjes, ndërsa komuniteti rom identifikon racën dhe etninë si shkaktarë kryesorë (41%).
- Format:** Shumica e konsiderueshme e të anketuarve LGBTI+ (87%) i vlerëson stereotipet si gjuhë urrejtjeje, krahasuar me 65% të të anketuarve romë që i konsiderojnë po njësoj fyerjet etnike. Të dy komunitetet njohin nxitjen e urrejtjes dhe sulmet verbale si forma kritike të gjuhës së urrejtjes.
- Ndikimi:** Të anketuarit romë e lidhin gjuhën e urrejtjes me dhimbjen emocionale dhe turpin, ndërsa të anketuarit LGBTI+ raportojnë se ndihen të kërcënuar dhe në ankth.

## PËRVOJA ME GJUHËN E URREJTJES

- Ekspozimi personal:** Përafërsisht 57% e të gjithë të anketuarve raportojnë se nuk kanë përvojë personale me gjuhën e urrejtjes, një rënie e lehtë nga 61% në vitin 2021. Rreth 14% tregojnë përvoja personale, ndërsa 32% kanë dëgjuar për të tjerë që janë përballur me gjuhën e urrejtjes. Komuniteti LGBTI+ raporton një shkallë më të lartë ekspozimi (62%), ndërsa përvojat e komunitetit rom kanë rënë nga 45% në 37%.
- Masat e marra:** Mes të anketuarve LGBTI+, 62% që ishin dëshmitarë të gjuhës së urrejtjes ndërmorën masa, krahasuar me rreth një të tretën e të anketuarve romë, duke treguar kështu nivele të ndryshme proaktiviteti.
- Gjuha e urrejtjes në internet:** Individët LGBTI+ raportojnë ekspozim më të shpeshtë ndaj gjuhës së urrejtjes në internet (36%) krahasuar me komunitetin rom (23%). Shumë prej tyre zgjedhën të fshinin ose të injoronin mesazhet e urrejtjes, ndërsa të anketuarit LGBTI+ ishin më proaktivë në raportimin e incidenteve.

## NIVELI I NDËRGJEGJËSIMIT DHE BESIMIT NË INSTITUCIONE

- **Ndërgjegjësimi për ligjet:** Ndërgjegjësimi i përgjithshëm për ligjet kundër gjuhës së urrejtjes është rritur nga 41% në vitin 2021 në 57% në vitin 2024, ndërsa të anketuarit LGBTI+ tregojnë ndërgjegjësim më të madh (41%) krahasuar me të anketuarit rom (17%).
- **Besimi në institucione:** Besimi në institucione si shkolla, organizata të shoqërisë civile dhe organe ndërkombëtare mbetet i fortë, megjithëse besimi në institucionet fetare ka rënë ndjeshëm, nga 39% në vitin 2021 në 24% në vitin 2024. Të dy komunitetet më së shumti i drejtohen familjes dhe miqve për mbështetje, por kanë dallim në besimin e tyre tek organizatat e shoqërisë civile dhe agjencitë e zbatimit të ligjit - individët LGBTI+ favorizojnë organizatat civile, ndërsa të anketuarit rom kanë më shumë besim te policia.
- **Pengesa për të kërkuar ndihmë:** Shumë të anketuar shprehin bindjen se askush nuk do të interesohej për situatën e tyre, gjë që kontribuon në ngurrimin e tyre për të kërkuar ndihmë.

## HYRJE: GJUHA E URREJTJES DHE KONTEKSTI SHQIPTAR

Gjuha e urrejtjes, që përfshin të gjitha llojet e shprehjeve që nxisin, promovojnë, përhapin ose justifikojnë dhunën, urrejtjen ose diskriminimin ndaj individëve ose grupeve bazuar në karakteristikat ose statusin e tyre personal, është shfaqur si një problem shqetësues në Shqipëri. LGBTI Ky studim i bën një analizë të thellë gjuhës së urrejtjes në Shqipëri, duke eksploruar perceptimet, përvojat dhe përgjigjet institucionale. Ai bazohet në gjetjet e raportit të vitit 2021: *Përtej përkufizimeve: Thirrje për Veprim Kundër Gjuhës së Urrejtjes në Shqipëri*, duke kontekstualizuar ndryshimet me kalimin e kohës dhe duke identifikuar sfidat e vazhdueshme. Me fokus te ndërsektorialiteti, studimi thekson se si cënueshmëritë e mbivendosura përkeqësojnë ndikimet e gjuhës së urrejtjes. Përmes metodave të përziera, duke përfshirë një anketë përfaqësuese në nivel kombëtar dhe një mostër të synuar të grupeve në rrezik, studimi synon të mbushë boshllëqet kritike të njohurive. Ai thekson rolin e medias tradicionale dhe digjitale si katalizator për gjuhën e urrejtjes dhe platformë për ndërhyrje të mundshme. Gjetjet zbulojnë natyrën e përhapur të gjuhës së urrejtjes në fusha të ndryshme, sidomos në arsim, në vendin e punës dhe hapësirat në internet, duke nënvizuar nevojën për strategji gjithëpërfshirëse dhe të synuara.

Gjithashtu, studimi është në përputhje me kuadrin ndërkombëtar, siç është Rekomandimi CM/Rec(2022)16 i Këshillit të Europës, i cili bën thirrje për qasje të diferencuara në luftën kundër gjuhës së urrejtjes, duke filluar nga sanksionet penale për rastet më të rënda, përdorimi i procedurave civile ose administrative, deri te fushatat e ndërgjegjësimit dhe këndvështrimet alternative për shprehje më pak të dëmshme. Ky përafrim siguron që rekomandimet e paraqitura në këtë raport të jenë të informuara nga praktikatat më të mira globale dhe të përshtatura me nevojat specifike të Shqipërisë. Duke paraqitur këtë kërkim, studimi synon t'u japë politikëbërësve, shoqërisë civile dhe palëve të interesuara ndërkombëtare konkluzione të bazuara në të dhëna për të përmirësuar kuadrin ligjor të Shqipërisë, për të rritur ndërgjegjësimin publik dhe besimin institucional. Përmes adresimit të shkaktarëve sistemikë të gjuhës së urrejtjes dhe promovimit të përfshirjes, ky raport kontribuon në qëllimin më të gjerë të inkurajimit të një shoqërie që mbështet dinjitetin njerëzor, barazinë dhe respektin për diversitetin.

## PËRKUFIZIME, ÇËSHTJE AKTUALE DHE SFIDA QË LIDHEN ME GJUHËN E URREJTJES NË SHQIPËRI

Rekomandimi i Këshillit të Europës CM/Rec(2022)16<sup>1</sup> e përkufizon gjuhën e urrejtjes si:

***“të gjitha llojet e shprehjeve që nxisin, promovojnë, përhapin ose justifikojnë dhunën, urrejtjen ose diskriminimin ndaj një personi ose grupi personash, ose që i denigron ata, për shkak të karakteristikave personale reale ose të atribuara ose statusit të tyre, siç janë ‘raca’, ngjyra, gjuha, feja, kombësia, origjina kombëtare ose etnike, mosha, aftësia e kufizuar, seksi, identiteti gjinor dhe orientimi seksual” (Këshilli i Europës, 2022, paragrafi 2).***

Në Shqipëri, gjuha e urrejtjes pasqyron tendencat më të gjera europiane, por formohet edhe nga faktorë të dallueshëm kulturorë dhe socio-politikë. Në objektiv janë veçanërisht grupet e pambrojtura si komunitetet rome dhe egjiptiane, personat LGBTI+, migrantët dhe gratë në mbrojtje të barazisë. Shtrirja dhe ashpërsia e gjuhës së urrejtjes në Shqipëri ndikohen nga faktorë të ndryshëm, sidomos stigmatizimi historik, përgjigjet e pamjaftueshme institucionale dhe tensionet në rritje të përkeqësuar nga kriza si pandemia COVID-19 dhe paqëndrueshmëria socio-ekonomike.<sup>2</sup>

1 Këshilli i Europës, Rekomandim CM/Rec(2022)16 për luftën kundër gjuhës së urrejtjes, 2022.

Lidhja: <https://rm.coe.int/recommendation-cmrec-2022-16-on-combating-hate-speech/1680a6d32d>

2 Këshilli i Europës, Studim për parandalimin dhe luftën kundër Gjuhës së Urrejtjes në kohë krize, 2023.

Lidhja: <https://rm.coe.int/study-on-preventing-and-combating-hate-speech-in-times-of-crisis/1680a5db8f>

## KUADRI PËR ADRESIMIN E GJUHËS SË URREJTJES

Rekomandimi CM/Rec(2022)16 ofron një kuadër të strukturuar për t'iu përgjigjur gjuhës së urrejtjes përmes një qasjeje të diferencuar bazuar në ashpërsinë e shprehjes. Masat e propozuara përfshijnë:

1. **Dënime penale** për raste të rënda që nxisin dhunë ose urrejtje.
2. **Zgjidhje juridike civile ose administrative** për shprehje të dëmshme, por jo kriminale.
3. **Përgjigje alternative**, të tilla si kundër-gjuha, fushatat e ndërgjegjësimit dhe dialogu ndërkulturor për shprehjet fyese që nuk përmbushin parametrat ligjore sipas Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (Këshilli i Europës, 2022, paragrafi 3).

Rekomandimi thekson rëndësinë e analizës kontekstuale, duke marrë parasysh përmbajtjen, qëllimin, përhapjen dhe audiencën e gjuhës së urrejtjes. Për më tepër, ai nënvizon efektet kumulative të formave të ndërthurura të diskriminimit dhe nevojën për përgjigje të ndjeshme ndaj gjinisë dhe moshës (Këshilli i Europës, 2022, paragrafi 6d). Në Shqipëri, përpjekjet institucionale për të luftuar gjuhën e urrejtjes mbeten të fragmentuara dhe të paqëndrueshme. Pavarësisht ekzistencës së ligjeve që ndalojnë gjuhën e urrejtjes, mekanizmat e zbatimit janë të dobët dhe ndërgjegjësimi publik për mbrojtjet ligjore është i kufizuar. Ky hendek ndërmjet politikave dhe praktikës përkeqëson cënueshmërinë e grupeve të marginalizuara.

Në dhjetor 2019, u krijua "Aleanca kundër Gjuhës së Urrejtjes", që mbledhi institucione kyçe si Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Autoriteti i Medias Audiovizuale dhe Këshilli i Medias Shqiptare për të luftuar gjuhën e urrejtjes dhe për të promovuar diversitetin në Shqipëri. E mbështetur nga Instrumenti Horizontal i BE-së/Këshillit të Europës për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, Aleanca përqendrohet në rritjen e ndërgjegjësimit, nxitjen e bashkëpunimit me partnerët strategjikë dhe miratimin e praktikave më të mira europiane. "Aleanca kundër Gjuhës së Urrejtjes" përbën një qasje të përbashkët në luftën kundër gjuhës së urrejtjes dhe promovimin e diversitetit në Shqipëri dhe më konkretisht synon: të zhvillojë materiale komunikimi dhe informimi për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të promovuar diversitetin dhe lirinë e shprehjes, të tilla si broshura, raporte, fushata PSA, etj., për të arritur audiencën e tyre dhe shoqërinë e gjerë; të rrisë bashkëpunimin me organizata dhe agjenci të tjera partnere strategjike që kanë një rol të rëndësishëm në luftën kundër diskriminimit, të tilla si Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, ofruesit e shërbimeve të internetit (ISP), organizatat e gazetarëve, organizatat e shoqërisë civile, organizatat e mbrojtjes së konsumatorit, etj.; të mbështesë partnerët në identifikimin e mekanizmave efektive për të luftuar gjuhën e urrejtjes bazuar në praktikën më të mira europiane; të identifikojë mekanizmat për përmirësimin e shkëmbimit të informacionit dhe trajnimin e stafit.

## VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM PËR GJUHËN E URREJTJES NË SHQIPËRI

Gjuha e urrejtjes në Shqipëri është një çështje e vazhdueshme dhe shumëdimensionale, e ndërthurur thellë me kontekstin socio-ekonomik dhe politik të vendit. Objekti i saj janë grupe të synuara si migrantët, personat LGBTI+, gratë dhe pakicat etnike, shpesh duke u intensifikuar gjatë periudhave të krizës. Edhe pse Shqipëria ka bërë progres në rritjen e ndërgjegjësimit publik për gjuhën e urrejtjes, sfidat sistematike dhe pabarazitë strukturore vazhdojnë të nxisin narrativa diskriminuese. Më poshtë jepet një përmbledhje e detajuar e tendencave dhe shtysave kryesore të gjuhës së urrejtjes në vend:

**Migracioni dhe Lëvizjet e Refugjatëve<sup>3</sup>:** Gjuha e urrejtjes e lidhur me migracionin është rritur ndjeshëm, veçanërisht në përgjigje të mbërritjes së azilkërkuarve afganë dhe migrantëve të tjerë gjatë viteve të fundit. Diskursi publik, shpesh i formësuar nga media dhe platformat politike, i portretizon migrantët si barrë ekonomike ose kërcënime për sigurinë. Kjo retorikë nuk është vetëm ksenofobike, por edhe përjashtuese, duke rrezikuar përpjekjet e integritit dhe duke vazhduar stigmën kundër refugjatëve. Figurat politike herë pas here kanë përdorur këto narrativa për të mobilizuar mbështetje popullore, duke ushqyer më tej ndjenjat kundër migrantëve në vetëdijen publike.

- **Personat LGBTI+ dhe Narrativat Anti-Gjinore:** Gjuha e urrejtjes që synon komunitetin LGBTI+ në Shqipëri mbetet e përhapur, veçanërisht gjatë debateve rreth reformave legjislativë si martesë e personave të të njëjtit seks dhe legjislacioni për njohjen e gjinisë. Narrativat anti-gjinore i paraqesin këto reforma si kërcënime për traditat shqiptare, duke nxitur diskriminim të përhapur. Kjo retorikë përhapet nga aktorë politikë, udhëheqës fetarë dhe grupe konservatore. Një raport i ILGA-Europe i vitit 2023 nxjerr në pah rritjen e abuzimit në internet ndaj transgjitorëve në Shqipëri dhe rajon, shpesh të lidhur me fushata më të gjera globale anti-LGBTI+. Platformat e medias sociale janë bërë arena qendrore për gjuhën e urrejtjes, ku anonimat dhe rregullimi i kufizuar e përkeqësojnë problemin.

3 Rrjeti European kundër Racizmit (ENAR), Shadow Report on Racism in Europe, 2022.  
Lidhja: <https://www.enar-eu.org/Shadow-Reports-on-racism-in-Europe>

- **Gratë dhe Gjuha e Urrejtjes me Bazë Gjinore:** Gjuha e urrejtjes me bazë gjinore synon në mënyrë disproporcionale gratë që mbrojnë barazinë, të drejtat e riprodhimit ose pjesëmarrjen në jetën publike dhe politike. Aktivistët e të drejtave të grave, gazetarët dhe figurat politike shpesh i nënshtrohen kërcënimeve për dhunë, fyerjeve mizogjene dhe përpjekjeve për të diskredituar integritetin e tyre profesional. Këto sulme, të amplifikuara nga aktorët politikë dhe fetarë, i dekurajojnë gratë për të mos u angazhuar në diskursin publik, duke rrezikuar kështu proceset demokratike të Shqipërisë. Sipas Lobimit European të Grave (2021)<sup>4</sup>, ky fenomen është pjesë e një modeli më të gjerë në të gjithë Europën, ku gjuha e urrejtjes përdoret si mjet për të heshtur gratë dhe për të ruajtur strukturat patriarkale.
- **Racizmi:** Gjuha e urrejtjes kundër komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri është e përhapur, veçanërisht gjatë krizave të shëndetit publik ose periudhave të vështirësive ekonomike. Këto grupe shpesh përshkruhen si të padenja për mbështetjen e shtetit, duke përforcuar përjashtimin sistemik dhe stigmatizimin social.

## MEDIA DHE PLATFORMAT DIGJITALE SI KATALIZATORË NË SHQIPËRI

Ka raporte që tregojnë se si media tradicionale ashtu edhe ajo digjitale në Shqipëri<sup>5</sup> luajnë një rol të dyfishtë në amplifikimin dhe luftën kundër gjuhës së urrejtjes. Raportohet se shpesh platformat tradicionale, siç janë programet politike dhe programet e realitetit, veprojnë si inkubatorë për retorikë diskriminuese. Në veçanti, programet politike përdoren shpesh nga figurat politike për të përhapur narrativa nxitëse, duke shfrytëzuar sensacionin për të tërhequr vëmendjen e publikut. Ndërkohë, programet e realitetit ruajnë stereotipet e dëmshme, veçanërisht për komunitetet e marginalizuara si romët, personat LGBTI+ dhe gratë, duke i paraqitur ato në mënyra që përforcojnë paragjykimet shoqërore.

Në të njëjtat raporte, platformat digjitale, me shtrirjen e tyre të gjerë dhe anonimatin, janë shfaqur si kanale të rëndësishme për ngacmimin në internet. Platformat e medias sociale si Facebook, Instagram dhe TikTok shpesh përdoren si armë për të përhapur gjuhën e urrejtjes, duke synuar veçanërisht personat LGBTI+, gratë dhe pakicat etnike. Abuzimi në internet, sidomos fyerjet, kërcënimet dhe shpifjet, është rritur vitet e fundit, duke përkuar me praninë digjitale në rritje të zërave të marginalizuar që mbrojnë barazinë dhe të drejtat. Anonimati i ofruar nga këto platforma u mundëson autorëve të shmangin llogaridhënien, ndërsa kuadri i dobët rregullator e përkeqëson çështjen. Në Shqipëri, përpjekjet për të zhvilluar kundër-narrativa janë ende në fillimet e tyre. Organizatat e shoqërisë civile kanë luajtur një rol kyç në promovimin e rrëfimit pozitiv dhe adresimin e dezinformimit, megjithatë shtrirja e tyre mbetet e kufizuar krahasuar me ndikimin e përhapur të gjuhës së urrejtjes në internet. Ajo që nevojitet urgjentisht janë fushatat e ndërgjegjësimit publik që forcojnë aftësinë rikuperuese ndaj narrativave të dëmshme, së bashku me angazhimin konstruktiv me median për të inkurajuar raportimin e përgjegjshëm dhe përmbajtjen gjithëpërfshirëse. Në të njëjtën kohë, partneritete më të forta ndërmjet kompanive të teknologjisë, shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore janë thelbësore për të frenuar në mënyrë efektive abuzimin në internet. Për më tepër, roli i dyfishtë i medias si katalizator dhe zbutës i mundshëm nënvizon nevojën për një qasje me nuanca. Programet e trajnimit për gazetarët dhe profesionistët e medias janë thelbësore për të ulur paragjykimet në raportim dhe për të nxitur praktikën etike. Përveç kësaj, fuqizimi i përdoruesve digjitalë përmes iniciativave të edukimit për median mund të ndihmojë audiencën që të vlerësojë në mënyrë kritike përmbajtjen dhe t'i rezistojë narrativave të dëmshme.

Përmes veprimeve të koordinuara që adresojnë si nxitësit ashtu edhe manifestimet e gjuhës së urrejtjes në median tradicionale dhe digjitale, Shqipëria mund të bëjë përparim domethënës drejt krijimit të një diskursi publik më gjithëpërfshirës dhe respektues.

## SFIDAT NË LUFTËN KUNDËR GJUHËS SË URREJTJES

Disa sfida strukturore pengojnë përpjekjet për të luftuar në mënyrë efektive gjuhën e urrejtjes në Shqipëri:

1. **Kuadri ligjor:** Edhe pse legjislacioni shqiptar e ka kriminalizuar gjuhën e urrejtjes, paqartësitë në përkufizime dhe zbatimin e paqëndrueshëm kufizojnë efikasitetin e këtyre dispozitave. Përafrimi i legjislacionit kombëtar me standardet ndërkombëtare mbetet një përparësi kritike.

Në legjislacionin civil dhe administrativ në Shqipëri ekziston një përkufizim i gjuhës së urrejtjes në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", (të ndryshuar me ligjin Nr.

4 Lobimi European i Grave (EWL), Digital Violence Against Women in Europe, 2021.

Lidhja: <https://www.womenlobby.org/Digital-Violence-Against-Women-in-Europe>

5 [Media Monitoring Report on Hate Speech in Albania \(2024\)](https://www.reportingdiversity.org/wp-content/uploads/2024/04/Media-Monitoring-Report_Albania_ENG.pdf?utm_source=chatgpt.com), Link [https://www.reportingdiversity.org/wp-content/uploads/2024/04/Media-Monitoring-Report\\_Albania\\_ENG.pdf?utm\\_source=chatgpt.com](https://www.reportingdiversity.org/wp-content/uploads/2024/04/Media-Monitoring-Report_Albania_ENG.pdf?utm_source=chatgpt.com)

124/2021), në nenin 3, pika 8, që lexon: "8. "Gjuha e urrejtjes" është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1<sup>6</sup> të këtij ligji."

- 1. Ndërgjegjësimi Publik<sup>7</sup>:** Pavarësisht ndërgjegjësimit të lartë për termin "gjuhë e urrejtjes", një pjesë e konsiderueshme e popullsisë nuk i kupton implikimet e tij më të gjera. Grupet vulnerabel si komuniteti rom raportojnë nivele edhe më të ulëta ndërgjegjësimi, duke nënvizuar nevojën për nisma të synuara edukimi.
- 2. Besimi institucional<sup>8</sup>:** Besimi në institucionet e ngarkuara me adresimin e gjuhës së urrejtjes, siç janë organet e zbatimit të ligjit dhe kundër diskriminimit, mbetet i ulët, veçanërisht mes komuniteteve të margjinalizuara. Kjo mungesë besimi dekurajon raportimin dhe rrezikon llogaridhënien.
- 3. Ndërsektorialiteti<sup>9</sup>:** Cenueshmëritë e mbivendosura të grupeve të margjinalizuara, përfshirë gratë, personat LGBT-TI+ dhe komunitetet rome, krijojnë sfida komplekse që kërkojnë qasje gjithëpërfshirëse dhe ndërsektoriale.

## HAPAT E RADHËS

Për t'ju përgjigjur këtyre sfidave, Shqipëria duhet të zbatojë një qasje gjithëpërfshirëse dhe me shumë palë të interesuara, siç përcaktohet në Rekomandimin CM/Rec(2022)16. Rekomandimet kryesore janë:

- **Forcimi i Mbrojtjes Ligjore:** Të qartësohet dhe të zbatohen ligje për gjuhën e urrejtjes, duke siguruar përafrimin me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Të zhvillohen mekanizma specifikë për të adresuar në mënyrë efektive gjuhën e urrejtjes në internet.
- **Fushatat Edukative:** Të promovohet edukimi për median dhe dialogu ndërkulturor, veçanërisht mes të rinjve, për të krijuar rezistencë ndaj narrativave të urrejtjes. Të përfshihet ndërgjegjësimi për gjuhën e urrejtjes në programet mësimore në shkolla.
- **Fuqizimi i Shoqërisë Civile:** Të mbështeten organizatat e shoqërisë civile për monitorimin, raportimin dhe luftën kundër gjuhës së urrejtjes. Grupe si Aleanca LGBTI+ dhe organizatat në mbrojtje të romëve janë aleatë kritikë në këtë përpjekje.
- **Përgjegjshmëria e Medias:** Të bashkëpunohet me median për të siguruar praktikën e raportimit etik dhe për të zvogëluar retorikën nxitëse. Të inkurajohen platforma të medias sociale për të zbatuar politika dhe mekanizma transparente raportimi.

Gjuha e urrejtjes në Shqipëri pasqyron një ndërveprim kompleks të dinamikave lokale dhe tendencave më të gjera europiane. Edhe pse është bërë progres për rritjen e ndërgjegjësimit dhe fillimin e përgjigjeve institucionale, mbeten boshllëqe të konsiderueshme në zbatim, edukim dhe rritje besimi. Duke i trajtuar këto sfida përmes një kuadri gjithëpërfshirës dhe ndërsektorial, Shqipëria mund të nxisë një shoqëri rezistente ndaj gjuhës së urrejtjes dhe të përkushtuar ndaj parimeve të barazisë dhe të të drejtave të njeriut.

## STUDIM KRAHASUES I GJUHËS SË URREJTJES NË SHQIPËRI: ANALIZË E VITIT 2021 DHE 2024<sup>10</sup>

Kjo analizë krahasuese shqyrton në mënyrë kritike gjetjet nga raportet e viteve 2021 dhe 2024 mbi gjuhën e urrejtjes në Shqipëri, duke u përqendruar në ndryshimet në ndërgjegjësim, perceptim, përgjigje institucionale dhe ndikim shoqëror gjatë periudhës trevjeçare. Duke integruar të dhëna sasiore dhe vëzhgime cilësore, ky studim ofron një kuptim të ngjyruar të sfidave të vazhdueshme dhe dinamikës në zhvillim të gjuhës së urrejtjes, ku vëmendje e veçantë i kushtohet grupeve të synuara si komunitetet LGBTI+ dhe rome.

6 Neni 1 i ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar përcakton: «Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.»

7 Monitoring Report on Hate Speech in Albania (Reporting Diversity, 2024) [https://www.reportingdiversity.org/wp-content/uploads/2024/04/Media-Monitoring-Report\\_Albania\\_ENG.pdf?utm\\_source=chatgpt.com](https://www.reportingdiversity.org/wp-content/uploads/2024/04/Media-Monitoring-Report_Albania_ENG.pdf?utm_source=chatgpt.com)

8 Beyond Definitions (CPD Albania, 2021) [https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2022/04/Hate-Speech-Study.-CPD-Albania-1.pdf?utm\\_source=chatgpt.com](https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2022/04/Hate-Speech-Study.-CPD-Albania-1.pdf?utm_source=chatgpt.com)

9 New Lines Institute: The Multifaceted Struggle of the LGBTQ+ Community in Albania, Link; [https://newlinesinstitute.org/wp-content/uploads/Alb-7-LGBTQ-1.pdf?utm\\_source=chatgpt.com](https://newlinesinstitute.org/wp-content/uploads/Alb-7-LGBTQ-1.pdf?utm_source=chatgpt.com)

10 Përtej përkufizimeve: Thirrje për veprim kundër gjuhës së urrejtjes në Shqipëri [///C:/Users/Admin/Downloads/BEYOND%20DEFINITIONS\\_ENG.pdf](https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2022/04/Hate-Speech-Study.-CPD-Albania-1.pdf?utm_source=chatgpt.com)

## 1. NDËRGJEGJËSIMI PËR DHE TË KUPTUARIT E GJUHËS SË URREJTJES

**Gjetjet e vitit 2021:** Raporti i vitit 2021 zbuloi se 96% e të anketuarve ishin në dijeni të termit “gjuhë e urrejtjes”. Megjithatë, ky ndërgjegjësim i lartë ishte sipërfaqësor, pasi vetëm një pjesë e popullsisë mund të artikulonte implikimet e saj më të gjera sociale dhe ligjore. Grupet vulnerabël, veçanërisht komuniteti rom/egjiptian, treguan boshllëk të theksuar në ndërgjegjësim, me 16% prej tyre që nuk kishin dijeni për konceptin. Mes popullsisë së përgjithshme, gjuha e urrejtjes kuptohej ngushtësisht si “ofendim i dikujt” ose përdorim i gjuhës përçmuese, duke reflektuar të kuptuarin e kufizuar të dimensioneve të saj strukturore dhe sistemike.

**Gjetjet e vitit 2024:** Në vitin 2024, njohja e përgjithshme me termin “gjuhë e urrejtjes” arriti në 97%, duke treguar se pothuajse të gjithë të anketuarit kishin dëgjuar të paktën për konceptin. Është e rëndësishme të theksohet se kjo rritje u shoqërua me të kuptuarit më të thellë konceptual: më shumë të anketuar ishin në gjendje ta lidhnin gjuhën e urrejtjes jo vetëm me gjuhën ofenduese, por edhe me implikimet e saj sistemike, të tilla si nxitja e urrejtjes dhe diskriminimi strukturor. Brenda grupeve të synuara, dallimet mbeten të dukshme. Komuniteti rom tregoi një përmirësim të ndjeshëm në nivelin e njohjes, duke u rritur nga 30% në vitin 2021 në 50% në vitin 2024. Ndër të anketuarit LGBTI+, perceptimet e gjuhës së urrejtjes si një fenomen shoqëror mbetën vazhdimisht të larta (84%), ku shumë prej tyre i njihnin në mënyrë të qartë dimensionet e saj strukturore dhe diskriminuese.

### Sipas seksit dhe grupmohës:

- Ndërgjegjësimi ishte më i lartë te femrat në të dy vitet, duke u rritur nga 95% në vitin 2021 në 97% në vitin 2024. Të anketuarit më të rinj (18-29 vjeç) treguan ndërgjegjësimin më të ulët në të dy anketat, me një përmirësim të vogël nga 59% në 63%.

### Të dhëna sipas statusit të punësimit dhe fesë:

- Të anketuarit e punësuar treguan ndërgjegjësim më të lartë (98% në vitin 2024) krahasuar me personat e papunë (94%).
- Myslimanët treguan ndërgjegjësim të qëndrueshëm (96% në vitin 2021, 97% në vitin 2024), ndërsa mes të krishterëve ortodoksë u vu re një rritje e dukshme nga 90% në 95%.

### Krahasimi i treguesve kyç:

- Ndërgjegjësimi u rrit me 1% në përgjithësi.
- Ndërgjegjësimi i komunitetit rom u përmirësua me 20%, duke reflektuar ndikimin e fushatave të synuara të informimit.
- Thellësia e të kuptuarit u përmirësua në 35% të të anketuarve LGBTI+, duke treguar qartësi konceptuale të përmirësuar.

**Vëzhgim kryesor:** Përmirësimi si i ndërgjegjësimit ashtu edhe i thellësisë së të kuptuarit pasqyron progresin në edukimin publik dhe mbrojtjen e interesave. Megjithatë, vazhdimësia e boshllëqeve mes grupeve të marginalizuara nënvizon nevojën për ndërhyrje të ndjeshme ndaj kulturës dhe specifike për kontekstin. Përmirësimi i komunitetit rom sugjeron që iniciativat e synuara japin rezultate të prekshme, megjithatë progresi i tyre më i ngadaltë krahasuar me komunitetin LGBTI+ nxjerr në pah pengesat sistemike që mbeten të pa trajtuara. Evoluimi në të kuptuarit nga përkufizimet sipërfaqësore në njohjen sistemike shënon një zhvendosje të rëndësishme në vetëdijen publike, megjithëse kjo mbetet e ndryshme mes të gjitha shtresave shoqërore.

## 2. PERCEPTIME PËR GJUHËN E URREJTJES

### Përhapja:

- **2021:** Perceptimi që gjuha e urrejtjes është e përhapur u konfirmua nga 58% e të anketuarve, me mbi 90% të grupeve të synuara që e identifikuan atë si një çështje të përhapur shoqërore. Komuniteti LGBTI+ dhe komuniteti rom/egjiptian raportuan vazhdimisht ekspozim të lartë ndaj gjuhës së urrejtjes, duke përmendur shpesh marginalizimin sistematik si shkakun e saj rrënjësor.
- **2024:** Deri në vitin 2024, perceptimi i gjuhës së urrejtjes si një fenomen i përhapur u rrit në 61%. Mes grupeve të synuara, perceptimet ndryshuan pak, me 65% të të anketuarve LGBTI+ që njohën gjuhën e urrejtjes sistemike krahasuar me 55% të të anketuarve romë.

### Të dhëna sipas seksit dhe grupmohës:

- Gratë kishin më shumë gjasa ta perceptonin gjuhën e urrejtjes si të përhapur në vitin 2024 (63%) krahasuar me burrat (58%). Të anketuarit e moshës 50-64 vjeç treguan perceptimin më të lartë të përhapjes (66%).

### Të dhëna sipas statusit të punësimit dhe fesë:

- Të krishterët ortodoksë treguan një rritje të ndjeshme në përhapjen e perceptuar, duke u rritur nga 49% në vitin 2021 në 56% në vitin 2024.
- Të anketuarit e punësuar raportuan vazhdimisht perceptime më të larta të gjuhës së urrejtjes (62% në vitin 2024) krahasuar me personat e papunë (57%).

**Ndikimi i medias:** Të dy studimet theksuan rolin e medias, veçanërisht debateve politike dhe programeve të realitetit, si platforma kryesore për përhapjen e gjuhës së urrejtjes. Në vitin 2024, programet e realitetit fituan epërsi më të madhe, duke reflektuar një rritje prej 9% në identifikimin si burime të gjuhës së urrejtjes krahasuar me vitin 2021. Anasjelltas, programet politike pësuan një rënie të lehtë në ndikimin e perceptuar nga **69% në 63%**.

### Krahasimi i treguesve kyç:

- Ndikimi i programeve të realitetit u rrit me **9%**.
- Ndikimi i perceptuar i debateve politike u ul me **6%**.
- Ekspozimi i grupeve të cenueshme ndaj perceptimeve të gjuhës së urrejtjes mbeti i qëndrueshëm mbi **90%**.

**Vëzhgim kryesor:** Perceptimi i gjuhës së urrejtjes si një çështje sistemike dhe jo si dukuri e izoluar tregon një ndërgjegjësim shoqëror që po maturohet. Megjithatë, roli në rritje i programeve të realitetit në televizion për vijimësinë e gjuhës së urrejtjes sinjalizon një ndryshim në panoramën mediatike që kërkon një shqyrtim më të kujdesshëm. Vazhdimësia e perceptimeve me përhapje të lartë mes grupeve të synuara tregon natyrën e rrënjësor të diskriminimit, duke kërkuar mbikëqyrje më të fortë rregullatore të platformave mediatike dhe strategji kundër-narrative më proaktive.

## 3. MOTIVI DHE FORMAT E GJUHËS SË URREJTJES

### Motivi:

- **2021:** Motivi për gjuhën e urrejtjes lidhet kryesisht me faktorë socio-ekonomikë, me varfërinë (54%) dhe statusin shoqëror (44%) të përmendur si shkaktarë kryesorë. Komuniteti LGBTI+ identifikoi homo-bi-lesbo-transfobinë si shkakun mbizotërues për gjuhën e urrejtjes, që prekte 68% të të anketuarve.
- **2024:** Deri në vitin 2024, fokusi te homo-bi-lesbo-transfobinë si motiv për gjuhën e urrejtjes u rrit, përveç kësaj 82% e të anketuarve LGBTI+ e identifikuan atë si motivin kryesor duke konfirmuar rritjen e identifikuar si trend të përgjithshëm. Për komunitetin rom, ata raportuan se etnia dhe raca ishin shkaktarë gjithnjë e më të spikatur, duke u rritur nga 41% në vitin 2021 në 50% në vitin 2024. Veçanërisht, anketa e përgjithshme tregon se mendimi politik si motiv u ul nga 44% në 28%.

### Të dhëna sipas seksit dhe grupmoshës:

- Gratë kishin më shumë gjasa të identifikonin varfërinë si një motiv kryesor në vitin 2024 (58%) krahasuar me burrat (49%).
- Të anketuarit e moshës 18-29 vjeç përmendën gjithnjë e më shumë përdorimin e medias sociale si shkaktare për gjuhën e urrejtjes, duke u rritur nga 33% në vitin 2021 në 42% në vitin 2024.

### Të dhëna sipas statusit të punësimit dhe fesë:

- Myslimanët kishin më shumë gjasa të identifikonin fenë si një shkaktare (27% në vitin 2024), krahasuar me të krishterët ortodoksë (18%).
- Të papunët identifikuan etninë dhe racën si shkaktarë kryesorë më shpesh (61%) se sa të anketuarit e punësuar (50%).

**Format:** Të dy studimet identifikuan nxitjen e urrejtjes, shpifjen dhe sulmet verbale si format më të përhapura të gjuhës së urrejtjes. Në vitin 2024, njohja e stereotipeve dhe shakave etnike si forma të rëndësishme të gjuhës së urrejtjes u rrit mes grupeve të synuara me **11%**, duke reflektuar një ndjeshmëri të shtuar ndaj formave delikate dhe indirekte të diskriminimit.

### Krahasimi i treguesve kyç:

- Homo-bi-lesbo-transfobia e identifikuar nga të anketuarit LGBT+ u rrit me **14%**.
- Shkaktarët e lidhur me etninë dhe racën të identifikuar nga të anketuarit romë u rritën me **9%**.
- Mendimi politik u ul me **16%**.

**Vëzhgime kryesore:** Intensifikimi i homo-bi-lesbo-transfobisë si motiv nxjerr në pah ndërthurjen e diskriminimit, ku orientimi seksual dhe identiteti gjinor bëhen pika qendrore të reagimit shoqëror. Njohja

në rritje e stereotipeve dhe shakave etnike si gjuhë urrejtjeje tregon përparim në të kuptuarit nga shoqëria, megjithatë vazhdimësia e këtyre formave nënvizon nevojën për ndryshime gjithëpërfshirëse kulturore për të sfiduar paragjykimet e rrënjosura.

#### 4. PËRVOJA ME GJUHËN E URREJTJES

##### Ekspozimi personal:

- **2021:** 14% e popullsisë së përgjithshme raportoi përvoja personale me gjuhën e urrejtjes, duke u rritur në 46% mes grupeve të synuara. Platformat online u identifikuan si kanale të rëndësishme për gjuhën e urrejtjes, veçanërisht nga komuniteti LGBTI+, ku 32% raportuan ngacmime të shpeshta.
- **2024:** Ekspozimi personal mes grupeve të synuara mbeti i lartë, me 36% të të anketuarve LGBTI+ që përmendën ngacmime të shpeshta në internet. Incidentet e gjuhës së urrejtjes në internet mes të anketuarve romë u rritën nga 23% në 31%.

##### Konteksti ku përjetohet gjuha e urrejtjes (sipas grupmoshës):

- **2021:**
  - o Të anketuarit më të rinj (18-29 vjeç) identifikuan mediat sociale (64%) dhe institucionet arsimore (41%) si mjediset kryesore ku përjetohet gjuha e urrejtjes.
  - o Të anketuarit e moshës 30-49 vjeç përmendën gjithashtu mediat sociale (58%), të ndjekur nga vendi i punës (39%).
  - o Të anketuarit më të vjetër (50-64 vjeç) theksuan mjediset e komunitetit (43%) dhe mediat tradicionale (35%) si kontekstet kryesore ku ata hasin gjuhën e urrejtjes.
- **2024:**
  - o Mes të anketuarve më të rinj, ekspozimi në median sociale ndaj gjuhës së urrejtjes u rrit në 71%, ndërsa në institucionet arsimore mbeti i qëndrueshëm në 40%.
  - o Të anketuarit e moshës 30-49 vjeç treguan rritje të ekspozimit ndaj gjuhës së urrejtjes në vendin e punës në 45%, me ekspozimin në mediat sociale që mbeti i lartë në 65%.
  - o Të anketuarit më të vjetër vazhduan të raportnin gjuhën e urrejtjes në mjediset e komunitetit (48%) dhe mediat tradicionale (37%), të dyja me një rritje të lehtë.

##### Ekspozimi ndaj gjuhës së urrejtjes në internet:

- **2021:** Përafërsisht 20% e popullsisë së përgjithshme raportoi ekspozim ndaj gjuhës së urrejtjes në internet. Grupet e synuara, veçanërisht të anketuarit LGBTI+, raportuan ekspozim më të lartë, me 32% që tregonin ngacmime të shpeshta në internet. Mes të anketuarve romë, 23% kishin përjetuar gjuhën e urrejtjes në internet.
- **2024:** Ekspozimi i përgjithshëm ndaj gjuhës së urrejtjes në internet u rrit në 25%. Të anketuarit LGBTI+ raportuan rritje të ndjeshme të ekspozimit në 36%, ndërsa të anketuarit romë gjithashtu përjetuan një rritje, me 31% që raportuan incidente të gjuhës së urrejtjes në internet. Të anketuarit më të rinj (18-29 vjeç) treguan shkallën më të lartë të ekspozimit në internet, duke u rritur nga 35% në vitin 2021 në 42% në vitin 2024.

##### Të dhëna sipas seksit:

- Burrat raportuan ekspozim pak më të lartë ndaj gjuhës së urrejtjes në internet (26% në vitin 2024) krahasuar me gratë (24%).

##### Të dhëna sipas fesë:

- Myslimanët raportuan shkallë më të larta të ekspozimit në internet mes grupeve fetare, duke shënuar rritje nga 18% në vitin 2021 në 27% në vitin 2024.

**Masat e marra:** Në vitin 2024, 62% e të anketuarve LGBTI+ raportuan se kishin marrë masa kundër gjuhës së urrejtjes, krahasuar me 46% në vitin 2021. Mes të anketuarve romë, marrja e masave u rrit pak nga 32% në 35%, duke theksuar pabarazitë në aksesin në burime.

##### Krahasimi i treguesve kyç:

- Ngacmimi në internet për të anketuarit romë u rrit me **8%**.
- Ekspozimi i LGBTI+ ndaj gjuhës së urrejtjes në internet u rrit me **4%**.

- Të anketuarit më të rinj përjetuan një rritje prej **7%** në ekspozimin ndaj gjuhës së urrejtjes në internet.

**Vëzhgime kryesore:** Digjitalizimi i gjuhës së urrejtjes e ka rrënjësuar ngacmimin në internet si një problem të vazhdueshëm, veçanërisht për personat LGBTI+. Ndërsa rritja e proaktivitetit mes grupeve të synuara është inkurajuese, dallimet në marrjen e masave pasqyrojnë pabarazi sistematike që kufizojnë veprimin e komuniteteve të caktuara. Adresimi i këtyre dallimeve kërkon iniciativa të synuara fuqizimi dhe sisteme mbështetëse të arritshme.

## 5. NDËRGJEGJËSIMI DHE BESIMI INSTITUCIONAL

### Ndërgjegjësimi për ligjet:

- **2021:** Vetëm 8% e të anketuarve ishin në dijeni të legjislacionit për gjuhën e urrejtjes, me grupet e synuara që treguan ndërgjegjësim pak më të lartë në 19%.
- **2024:** Ndërgjegjësimi u rrit ndjeshëm në 57%, me dallime të dukshme mes të anketuarve LGBTI+ (41%) dhe të anketuarve romë (17%).

### Të dhëna sipas seksit dhe grupmoshës:

- Gratë treguan ndërgjegjësim më të lartë për ligjet që mbrojnë kundër gjuhës së urrejtjes (61% në 2024) krahasuar me burrat (53%).
- Të anketuarit e moshës 30-49 vjeç treguan përmirësimin më të madh, me rritje nga 19% në 2021 në 58% në 2024.

### Institucionet e angazhuara për të luftuar gjuhën e urrejtjes

- **2021:** Organizatat e shoqërisë civile u identifikuan si institucionet më të besueshme për luftën kundër gjuhës së urrejtjes nga 38% e të anketuarve. Institucionet fetare pasuan me 24%, dhe agjencitë e zbatimit të ligjit u renditën në vend të tretë me 20%. Mes të anketuarve LGBTI+, besimi në organizatat e shoqërisë civile ishte dukshëm më i lartë (62%).
- **2024:** Besimi në organizatat e shoqërisë civile u rrit në 47%, duke u bërë edhe më i spikatur në 68% mes të anketuarve LGBTI+. Besimi në institucionet fetare ra në 19%, ndërsa mbeti i ulët për zbatimin e ligjit në 18%. Veçanërisht, të anketuarit më të rinj (18-29 vjeç) treguan se mbështeteshin gjithnjë e më shumë në platformat e mediave sociale për raportimin e gjuhës së urrejtjes, me rritje nga 10% në vitin 2021 në 17% në vitin 2024.

### Të dhëna sipas statusit të punësimit dhe fesë:

- Të anketuarit e punësuar shprehën besim më të lartë në organizatat e shoqërisë civile (50%) krahasuar me të papunët (43%).
- Të krishterët ortodoksë treguan rënien më të madhe të besimit ndaj institucioneve fetare, nga 28% në vitin 2021 në 15% në vitin 2024.

### Krahasimi i treguesve kyç:

- Besimi në organizatat e shoqërisë civile u rrit me **9%**.
- Besimi në institucionet fetare ra me **5%**.
- Mbështetja e të anketuarve më të rinj në median sociale për raportimin e gjuhës së urrejtjes u rrit me **7%**.

**Vëzhgime kryesore:** OSHC-të rezultojnë të marrin mbështetjen më të madhe për luftën kundër gjuhës së urrejtjes, duke reflektuar përpjekjet e suksesshme të avokimit dhe angazhimit të komunitetit. Megjithatë, rënia e besimit në institucionet fetare dhe stanjacioni në besimin në agjencitë e zbatimit të ligjit nënvizojnë çështjet sistematike që kërkojnë vëmendje urgjente. Mbështetja në rritje në platformat e medias sociale nga të anketuarit më të rinj nxjerr në pah një ndryshim në sjelljet e raportimit, duke bërë të domosdoshme mekanizma të përmirësuar të monitorimit dhe mbështetjes digjitale.

## REKOMANDIME NË LIDHJE ME GJUHËN E URREJTJES NË SHQIPËRI

### 1. Kuadri ligjor dhe përkufizimi i gjuhës së urrejtjes:

**1. Të formulohet një përkufizim i unifikuar dhe i saktë ligjor për "gjuhën e urrejtjes" në përputhje me CM/Rec(2022)16<sup>11</sup>.**

<sup>11</sup> Paragrafi 11 i Rekomandimit qartëson format e gjuhës së urrejtjes që duhet të kriminalizohen, ndërsa të tjerat mund të adresohen me masa administrative, civile ose jo-ligjore.

**Ky përkufizim duhet të identifikojë shprehimisht aktet e gjuhës së urrejtjes që nxisin ose justifikojnë dhunën, urrejtjen ose diskriminimin bazuar në karakteristikat e mbrojtura ose statusin, duke siguruar përputhshmëri në interpretim dhe zbatim nga gjykatat dhe institucionet publike. Përfshirja e këtij përkufizimi në Kodin Penal do të sigurojë qartësi dhe do të lehtësojë kategorizimin e gjuhës së urrejtjes si vepra penale të dallueshme, duke mbrojtur njëkohësisht lirinë e shprehjes.**

**2. Shërbime policore të specializuara për Gjuhën e Urrejtjes në internet:** Të krijohen shërbime policore dhe njësi të dedikuara brenda prokurorisë për të adresuar gjuhën e urrejtjes në internet. **Këto shërbime jo vetëm që duhet të zbatohen ligjin, por edhe të punojnë në mënyrë proaktive** në komunitete duke ofruar udhëzime, parandalim dhe mbështetje. **Pajisja e tyre me mjete të përparuara teknologjike dhe ofrimi i trajnimeve do të forcojë aftësinë e tyre për t'iu përgjigjur natyrës dinamike dhe komplekse të platformave digjitale.**

**3. Mbështetja për Viktimat dhe rritja e ndërgjegjësimit për mekanizmat e dëmshpërblimit:** Të prezantohen programe të ndihmës për viktimat të udhëhequra nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me fokus në ndërgjegjësimin për të drejtat e ligjshme dhe qasjen në drejtësi. Këto programe duhet të përfshijnë shërbime rehabilitimi dhe fushata edukative për të fuqizuar viktimat dhe për të frenuar gjuhën e urrejtjes në të ardhmen. Shumë viktima mbeten të pavetëdijshme për të drejtat e tyre ose mekanizmat në dispozicion për të kërkuar dëmshpërblim. Adresimi i këtij boshllëku do të rrisë mbështetjen për viktimat, duke përforcuar normat shoqërore kundër gjuhës së urrejtjes.

**4. Bashkëpunimi Ndërinstitucional dhe Ndërkombëtar:** Të inkurajohet bashkëpunimi mes institucioneve shqiptare, siç janë Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me organizatat ndërkombëtare për të ndarë praktikat më të mira, për të përditësuar njohuritë dhe për të harmonizuar strategjitë. Bashkëpunimi ndërkombëtar sjell njohuri të ndryshme dhe strategji të provuara që mund të forcojnë aftësinë e Shqipërisë për të luftuar gjuhën e urrejtjes në mënyrë efektive.

**5. Mbledhja e të dhënave dhe kërkimi:** Të krijohen mekanizma gjithëpërfshirëse për mbledhjen e të dhënave për të monitoruar incidentet e gjuhës së urrejtjes, duke përfshirë rastet që kanë në objektivat personat LGBTI+ dhe komunitetet romë. Të sigurohet që organet e pavarura të barazisë të bashkëpunojnë me organizatat e shoqërisë civile për mbledhjen dhe analizimin e këtyre të dhënave. Politikat e bazuara në të dhëna kërkojnë të dhëna të sakta dhe të besueshme për të adresuar në mënyrë efektive diskriminimin dhe gjuhën e urrejtjes.

**6. Ndërgjegjësimi dhe Edukimi Publik (Qasje me tre shtresa):** Të prezantohet një qasje e shtresuar ndaj parandalimit dhe edukimit:

- **Fushatat e përgjithshme publike të sfidojnë stereotipet dhe të promovojnë përfshirjen.**
- **Programe mësimore që integrojnë iniciativa kundër bullizmit dhe të udhëhequra nga kolegët në të gjitha nivelet e arsimit.**
- **Ndërhyrje në nivel komuniteti që angazhojnë udhëheqësit lokalë dhe personat me ndikim për të bërë rezistencë ndaj narrativave të urrejtjes.**

**7. Trajnimi për nëpunësit publikë:** Të ofrohet trajnim i detyrueshëm për barazinë dhe mosdiskriminimin për nëpunësit publikë, edukatorët, punonjësit e kujdesit shëndetësor, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe aktorët gjyqësorë. Trajnimi duhet të theksojë të drejtat e personave LGBTI+ dhe komuniteteve romë, veçanërisht aty ku ekziston diskriminimi institucional.

**8. Standardet Etike për Diskursin Politik dhe Publik:** Të inkurajohen partitë politike dhe figurat me ndikim që të miratojnë kode etike që ndalojnë gjuhën diskriminuese dhe promovojnë diskursin gjithëpërfshirës. Figurat publike duhet të sfidojnë në mënyrë aktive deklaratat dhe sjelljet diskriminuese.

**9. Përgjegjësia dhe Llogaridhënia e Medias:** Të bashkëpunohet me rregullatorët e medias për të zbatuar standardet etike për gazetarinë, duke siguruar që media masive të promovojë përfshirjen dhe të shmangë vijimësinë e stereotipeve. Gjithashtu subjektet mediatike duhet të inkurajohen të shfaqin zëra të ndryshëm, veçanërisht nga komunitetet LGBTI+ dhe romë.

**10. Kundërshtimi i gjuhës së urrejtjes përmes narrativave strategjike:** Të mobilizohen aktorët me ndikim në të gjithë shoqërinë civile, qeverinë dhe median për të zhvilluar kundër-narrativa kundër urrejtjes që promovojnë përfshirjen, tolerancën, diversitetin dhe të drejtat e njeriut. Të inkurajohen partneritete me platformat digjitale për të shumëfishuar këto narrativa.

## 2. Metodologjia e studimit

Anketa përfshiu një mostër me 1,000 të anketuar nga të gjitha qarqet e Shqipërisë, duke siguruar përfaqësim kombëtar. Intervistat u kryen duke përdorur dy metodologji: CATI (Intervistë telefonike me asistencë kompjuterike) dhe CAWI (intervista përmes internetit me asistencë kompjuterike), nga 20 shtatori deri më 17 tetor 2024. Përafërsisht **35% e intervistave u kryen nëpërmjet telefonit, ndërsa 65% u kryen përmes internetit**. Kohëzgjatja mesatare e intervistës ishte rreth 15 minuta. Një përshkrim i detajuar i këtyre metodologjive mund të gjendet në Aneksin e këtij raporti. Përveç kësaj, anketa përfshiu një mostër shtesë prej rreth 213 të anketuarish nga komunitetet LGBTI+Q dhe Rom/Egjiptian për të mbledhur këndvështrime mbi gjuhën e urrejtjes që prek këto grupe specifike.

Figura 1. Metodologjia për mbledhjen e të dhënave



### 2.1 SHPËRNDARJA E MOSTRËS

Popullata e synuar e studimit përfshinte individë 18- 64 vjeç, të konsideruar të kualifikuar për këtë anketim. Shpërndarja e mostrës u përcaktua duke përdorur shifra të përafërta zyrtare të popullsisë për këtë grupmoshë të kualifikuar. Bazuar në këto shifra të përafërta, numri i parashikuar i intervistave u nda sipas qarkut, duke siguruar që brenda secilit qark të ruhej shpërndarja urbane-rurale.

Figura 2. Shpërndarja e mostrës për çdo qark

	Përqindja	Numri
Berat	7%	70
Dibër	4%	44
Durrës	9%	89
Elbasan	10%	97
Fier	10%	104
Gjirokaster	3%	26
Korçë	8%	76
Kukës	3%	27
Lezhë	4%	42
Shkodër	7%	66
Tiranë	30%	299
Vlorë	6%	60
Gjithsej	<b>100%</b>	<b>1000</b>

Një madhësi mostre prej 1000 intervistash siguron një studim përfaqësues me një koeficient gabimi  $\pm 3.4$ , me interval besimi 95%.

## 2.2 KONCEPTIMI I INSTRUMENTIT TË ANKETËS

Pyetësi i anketës përfundimtare përbëhet nga afërsisht 22 pyetje të mbyllura (një kopje e tyre është përfshirë në këtë raport). Pyetjet u strukturuan sipas një radhe specifike, duke filluar me vlerësimin e njohurive të të anketuarve për gjuhën e urrejtjes. Këto u pasuan me pyetje mbi perceptimet e ndryshme që ata mund të kenë në lidhje me çështjen në vend. Më pas, pyetësi përfshinte pyetje që synonin matjen e përvojave personale me gjuhën e urrejtjes, duke përfunduar me pyetje rreth nivelit të besimit në institucione në lidhje me reagimin e tyre ndaj gjuhës së urrejtjes.

## 2.3 ANALIZIMI I TË DHËNAVE

Të dhënat analizohen për secilën pyetje në nivel kombëtar, si edhe sipas seksit, grupmoshave dhe zonës gjeografike, për të identifikuar çdo ndryshim mes segmenteve të ndryshme të popullsisë në lidhje me temat specifike të mbuluara në anketë (në këtë raport është përfshirë një listë e plotë e tabelave). Gjithashtu, të dhënat nga mostra shtesë vlerësohen bazuar në dy grupet kryesore të cenueshmërisë: personat LGBTI+ dhe komunitetet rom/egjiptian.

## 2.4 PËRZGJEDHJA E PJESËMARRËSVE TË ANKETËS

Të anketuarit u përzgjedhën duke përdorur metodologjitë CATI (Intervistë telefonike me asistencë kompjuterike) dhe CAWI. Bazuar në kuotat gjeografike të paracaktuara për anketën, operatorët kryen një vlerësim të shkurtër përpara se të fillonin intervistat aktuale. Ky proces siguroi që të gjenerohej numri i rastësishëm në përputhje me kuotat e specifikuar për secilin qark. Vlerësimi paraprak ishte gjithashtu thelbësor për të kuptuar profilet e të anketuarve, duke marrë parasysh faktorët demografikë si mosha dhe gjinia (në këtë raport është përfshirë një përshkrim i platformës CATI dhe metodologjisë CAWI).

Pasi u verifikuan kuotat, filloi **intervista kryesore**. Përpara fillimit, u mor pëlqimi me gojë nga të anketuarit. Operatorët i informuan pjesëmarrësit për përfshirjen e tyre vullnetare në anketë dhe sqaruan se nuk do të ndaheshin të dhëna në nivel individual, duke theksuar se i gjithë informacioni i mbledhura gjatë intervistave do të përdorej vetëm për analizimin e të dhënave.

## 2.5 ETIKA

### 2.5.1 Pëlqimi i informuar për pjesëmarrësit e anketës

Operatorët gjatë fazës së mbledhjes së të dhënave e kanë bërë të qartë se nuk ndaj të anketuarve nuk ka asnjë detyrim të shprehur apo të nënkuptuar, në mënyrë që ata të mund të marrin një vendim të informuar dhe të lirë mbi përfshirjen e tyre të mundshme në anketë. Të anketuarit ishin në dijeni për natyrën vullnetare të përfshirjes së tyre dhe që ata mund të tërhiqeshin nga anketa në çdo kohë pa pasoja negative.

### 2.5.2 Privatësia dhe konfidencialiteti

Të gjithë pjesëmarrësit në studim janë informuar se studimi është kryer duke respektuar anonimatën dhe se pjesëmarrja në anketë është plotësisht vullnetare. Operatorët u kanë bërë të qartë pjesëmarrësve se përgjigjet e tyre do të interpretohen vetëm në mënyrë kumulative dhe se asnjë informacion personal nuk do të përdoret ose nuk do t'i zbulohet një pale tjetër ose në rezultatet me shkrim.

Duke pasur parasysh që të anketuarit në këtë kërkim ndajnë informacion personal (p.sh., mosha, gjinia, numri i telefonit/adresa e email-it), ekipi i kërkimit ka përgjegjësi të sigurojë që të ruhet konfidencialiteti i tyre dhe që të mbrohet informacioni personal. Kjo do të vihet në zbatim duke siguruar që të gjitha grupet e të dhënave të jenë anonimizuar, në kuptimin që të gjitha të dhënat personale të të anketuarve të hiqen para se të dhënat të ndahen publikisht.

## Kufizimet e studimit

- 11. Perceptimi i Telemarketingut:** Shumë të anketuar mund t'i konsiderojnë telefonatat si mënyrë ndërhyrëse ose të ngjashme me telemarketingun, duke çuar në perceptime negative dhe ngurrim për të marrë pjesë. Është përlogaritur që operatorët duhej të bënin mesatarisht dy telefonata për çdo intervistë të suksesshme, gjë që tregon paragjykim të mundshëm në përzgjedhje të mostrës dhe normë të reduktuar të përgjigjes.
- 12. Kohëzgjatja e intervistave:** Kohëzgjatja e intervistave telefonike mund të përbëjë sfidë. Të anketuarit mund ta kenë të vështirë të angazhohen plotësisht në telefon, veçanërisht pa kontakt të drejtpërdrejtë, gjë që krijon keqkuptime të mundshme ose nevojën për përsëritje të pyetjeve, të cilat mund të ndikojnë në cilësinë e përgjigjeve.
- 13. Hendeku kohor që nga anketa e fundit:** Një hendek i konsiderueshëm prej katër vitesh që nga anketa e fundit mund të kufizojë aftësinë për të krahasuar gjetjet. Ndryshimet në qëndrimet dhe përvojat shoqërore që lidhen me gjuhën e urrejtjes mund të mos identifikohen mjaftueshëm, duke ndikuar në relevancën dhe saktësinë e tendencave me kalimin e kohës.

## 3. Gjetjet kryesore

Në këtë pjesë paraqitet një analizë gjithëpërfshirëse e gjetjeve nga anketa për gjuhën e urrejtjes. Analiza nuk zbaton në mënyrë strikte radhën e pyetësorit, por është e organizuar bazuar në një rrjedhë logjike të temave të ndryshme të trajtuara.

Në mënyrë specifike, analiza fillon me sfondin demografik të të anketuarve, të ndjekur nga perceptimet e tyre për gjuhën e urrejtjes. Pjesa tjetër përqendrohet në përvojat personale që lidhen me gjuhën e urrejtjes, dhe pjesa e fundit trajton ndërgjegjësimin për ligjet përkatëse dhe nivelin e besimit në institucionet përgjegjëse për adresimin e këtyre çështjeve në vend.

Për shkak të metodologjive të ndryshme, analiza do të ndahet në dy pjesë: një për popullsinë kombëtare, e cila bazohet në një përzgjedhje të rastësishme të të anketuarve, dhe një tjetër për mostrën shtesë, e cila u mbledh përmes intervistave të synuara.

### 3.1 PROFILI I POPULLATËS SË ANKETUAR

Anketa përfshinte një total prej 1,000 pjesëmarrësish<sup>12</sup>, të moshës 18 deri në 64 vjeç. Moshë mesatare e të anketuarve ishte 43 vjeç, ndërsa moshë mediane ishte 42 vjeç, që është një popullsi pak më e vjetër se anketa e fundit ku moshë mesatare ishte 39 vjeç. Përafërsisht 49% e të anketuarve u identifikuan si meshkuj, 51% si femra dhe një pjesëmarrës zgjodhi të mos e zbulonte gjininë<sup>13</sup>.

Figura 3. Të anketuarit sipas seksit. Publiku i gjerë.



Përafërsisht 54% e pjesëmarrësve jetonin në zona urbane, ndërsa 46% jetonin në zona rurale. Të dhënat rajonale tregojnë se rreth 30% e të anketuarve janë nga Tirana, 19% nga Veriu, 18% nga Qendra dhe 34% nga Jugu<sup>14</sup>.

12 Pjesëmarrësit (publiku i gjerë) këtu konsiderohen të anketuar që kanë plotësuar të gjithë pyetësorin.

13 Kur të dhënat të ndahen sipas seksit, të anketuarit që nuk preferuan të tregojnë gjininë nuk do të përfshihen, për shkak të numrit shumë të ulët.

14 Jug: Berat Fier Gjirokastrë Korçë Vlorë; Veri: Dibër Kukës Lezhë, Shkodër Qendër: Durrës Elbasan.

Figura 4. Të anketuarit sipas vendndodhjes urbane-rurale. Publiku i gjerë






Figura 5. Të anketuarit sipas qarkut. Publiku i gjerë.



Rreth 23% e të rinjve të anketuar ishin të moshës 18 - 29 vjeç, duke i klasifikuar ata si pjesë e popullsisë<sup>15</sup> së re. Përafërsisht 40% ishin mes moshës 30 - 49 vjeç, ndërsa 37% ishin mes moshës 50 - 64 vjeç.

Figura 6. Të anketuarit sipas grupmoshës



Të dhënat në lidhje me nivelin e arsimit të përfunduar tregojnë se 15% kanë përfunduar ciklin e parë të shkollës së mesme, 25% ciklin e dytë, 19% kanë një diplomë bachelor dhe 41% kanë një diplomë masteri (ose doktorature).

Rreth 22% e të anketuarve janë të papunë dhe rreth 70% janë të punësuar, shumica në sektorin privat. Instrumenti i të dhënave përfshinte edhe një pyetje në lidhje me fenë. Të dhënat treguan se më shumë se gjysma e të anketuarve deklaruan se ishin islamikë (47%), rreth 14% ortodoksë, rreth 9% katolikë dhe rreth 8% bektashinj. Një në dhjetë të anketuar deklaruan që nuk kishte orientim fetar.

Figura 7. Të anketuarit sipas nivelit arsimor. Publiku i gjerë





Figura 8. Të anketuarit sipas statusit të punësimit. Publiku i gjerë.



15 Përkufizimi i rinisë sipas Eurostat-it.

### 3.1.1 Profili i mostrës shtesë

Përveç mostrës kryesore, u intervistua një mostër shtesë prej 213 individësh, përfshirë anëtarë të komunitetit LGBTI+ dhe rom/egjiptian. Kjo qasje u ndoq bazuar në faktin që pjesëmarrësit në këtë grup janë kryesisht të ekspozuar ndaj fenomenit të gjuhës së urrejtjes. 2021 Që nga viti 2021, Shqipëria ka bërë përpjekje për të forcuar ligjet kundër gjuhës së urrejtjes, veçanërisht në përgjigje të përhapjes në rritje të gjuhës së urrejtjes në internet përmes platformave të mediave sociale, debateve të nxehta publike dhe të lidhura me zgjedhjet, dhe avokimit të vazhdueshëm nga shoqëria civile dhe partnerët ndërkombëtarë. Rishikimet në Kodin Penal dhe Ligjin për Median Audio-vizuale kanë synuar të ofrojnë përkufizime më të qarta të gjuhës së urrejtjes dhe të vendosin dënime më të rrepta për shkeljet. Përveç kësaj, janë prezantuar iniciativa për të promovuar tolerancën dhe për të luftuar diskriminimin. Pavarësisht përpertimeve në ligjet shqiptare që adresojnë çështjet sociale, mbetet tendenca për të diskriminuar këta persona, duke i kategorizuar ata si pjesë të një komuniteti të cenueshëm. Kjo mostër përbëhet nga 50% femra dhe 50% pjesëmarrës meshkuj nga grupi rom/egjiptian, ndërsa komuniteti LGBTI+ përfshin 44% meshkuj, 51% femra dhe 5% që preferojnë të mos e tregojnë gjininë (kryesisht jo-binari). Në anketën e mostrës shtesë të komunitetit LGBTI+, rreth tre të katërtat janë të moshës 18-29 vjeç dhe një e katërta janë 30-64 vjeç. Nga ana tjetër, komuniteti rom ka një përfaqësim më të lartë të pjesëmarrësve më të vjetër, me 64% të moshës 30-64 vjeç dhe vetëm 36% të moshës 18-29 vjeç.


Të dhënat arsimore tregojnë se të gjithë anëtarët e komunitetit LGBTI+ kanë përfunduar të paktën ciklin e dytë të shkollës së mesme (16%), me 44% që kanë një diplomë universitare dhe 37% që kanë kualifikime pasuniversitare. Nga ana tjetër, komuniteti rom tregon një tendencë të ndryshme: 24% nuk kanë arsim formal, 40% kanë përfunduar ciklin e parë të shkollës së mesme dhe 21% kanë përfunduar ciklin e dytë. Vetëm 6% kanë marrë diplomë universitare dhe 8% kanë diplomë pasuniversitare.

### 3.2 NJOHURIA PËR “GJUHËN E URREJTJES”

Vlerësimi i të kuptuarit të përgjithshëm të “gjuhës së urrejtjes” nga të anketuarit u bë përmes një grupi të strukturuar pyetjesh. Fillimisht, pjesëmarrësve iu bë pyetja nëse kishin dijeni për domethënien e gjuhës së urrejtjes, pa ndonjë orientim ose indicie. Për ata që treguan se nuk kishin dijeni për termin, pyetja pasuese ishte nëse i njihnin konceptet e gjuhës fyese ose diskriminuese. Nëse e konfirmonin këtë njohuri, pyetësori vazhdonte me një pyetje të hapur: “Çfarë kuptoni me termin “gjuhë e urrejtjes?”

Rezultatet tregojnë një **ritje të ndjeshme të ndërgjegjësimit për gjuhën e urrejtjes, me 72% të të anketuarve që tani e njohin termin, krahasuar me 60% në anketën e vitit 2021.** Kombinuar me 25% që e kuptojnë se çfarë përfshin gjuha diskriminuese ose fyese, rezulton se gjithsej 97% e pjesëmarrësve tani janë të vetëdijshëm për këto koncepte të rëndësishme. Mbetet kështu një pakicë e vogël prej 3% që ende **nuk ka dijeni për gjuhën e urrejtjes**,<sup>16</sup> duke theksuar një përmirësim të dukshëm në ndërgjegjësimin publik dhe të kuptuarit gjatë viteve të fundit. Ky ndryshim sugjeron që përpjekjet edukative dhe diskutimet publike rreth gjuhës së urrejtjes mund të kenë një ndikim pozitiv në njohuritë shoqërore.


Figura 9. A e dini çfarë është gjuha e urrejtjes? Publiku i gjerë.



16 Analizimi i të dhënave të temave të mëtejshme në këtë raport do të referohet vetëm 1000 të anketuarve që kishin dijeni për gjuhën e urrejtjes (që i referohet 94% të personave të kontaktuar në vitin 2021 dhe 97% në vitin 2024).

Të dhënat e kryqëzuara sipas gjinisë tregojnë se grupmosha 30-49 vjeç duket se ka vetëm më shumë dijeni për gjuhën e urrejtjes krahasuar me më të rinjtë. Konkretisht, 72% e individëve të moshës 18-29 vjeç raportuan se e kuptonin gjuhën e urrejtjes, ndërsa 78% e atyre të moshës 30-49 vjeç shprehën të njëjtën nivel ndërgjegjësimi.

Figura 10 A e dini çfarë është gjuha e urrejtjes? Publiku i gjerë.



Studimi përfshinte një pyetje të hapur për të kuptuar më thellë perceptimet e të anketuarve për termin “gjuhë e urrejtjes”. Kjo pyetje synonte të maste njohuritë e tyre për konceptin dhe të mësohej nëse ata e shoqëronin atë me terma të tjerë të lidhur me të.

Përgjigja më shpesh e përmendur ishte **të ofendosh dikë (29%)**. Në përputhje me gjetjet e anketës të vitit 2020, përgjigjet kryesore përfshinin gjithashtu referenca për urrejtje kundër grupeve të ndryshme, si dhe **urrejtje bazuar në shkaqe fetare ose racore (përkatësisht 20% dhe 16%)**. Tabela më poshtë përshkruan kategoritë më të identifikuara që lidhen me gjuhën e urrejtjes.

Tabela 1. Kategoritë kryesore dhe shkaqet për gjuhën e urrejtjes në përgjigje të pyetjes çfarë është gjuha e urrejtjes të bërë në anketimin e publikut të gjerë

Category	Percentage
To offend	29%
Unethical, derogatory language that incites hatred against various groups.	20%
Hatred, discrimination, denigration based on religion	16%
Hatred, discrimination, denigration on racial grounds	16%
Language that promotes physical and psychological violence	12%
Contempt	10%
Bullying	10%
Discrimination	9%
Anger towards someone/envy	9%
To hate someone	8%
Hatred, discrimination, denigration on sexual grounds	7%
To speak badly about someone	8%
Hatred, discrimination, gender-based denigration	6%
Hatred, discrimination, denigration on ethnic grounds	6%
Prejudices	5%
Hatred, discrimination, denigration due to economic status	5%
Nationalism	4%
Hatred because of appearance	3%
Hatred, discrimination, denigration based on politics	2%
Other terms	16%


### 3. 2. 1 Njohuria për gjuhën e urrejtjes mes mostrës shtesë

Në nëngrupin e identifikuar si në rrezik për të qenë objekt i gjuhës së urrejtjes, u përdor një metodologji e ngjashme për të vlerësuar se si e kuptojnë ata termin. Fillimisht, pjesëmarrësve iu bë pyetja: “Çfarë do të thotë për ty “gjuha e urrejtjes”? Kjo u pasua nga një sërë pyetjesh të lidhura.

**Gjetjet zbuluan se 73% e pjesëmarrësve të komunitetit LGBTI+ e kuptojnë qartë gjuhën e urrejtjes.** Ndërkohë, 20% pranuan se kishin dijeni për gjuhën diskriminuese ose ofenduese, megjithëse nuk mund ta përkufizonin gjuhën e urrejtjes, dhe vetëm 7% nuk ishin në dijeni as të gjuhës së urrejtjes dhe as të gjuhës diskriminuese. Krahasuar me vitin 2021, nuk janë vërejtur ndryshime të rëndësishme, me vetëm një rritje prej 2% në ndërgjegjësimin e komunitetit për gjuhën e urrejtjes.

**Nga ana tjetër, në komunitetin rom 50% e kuptojnë gjuhën e urrejtjes, kjo shënon një përmirësim të konsiderueshëm krahasuar me studimin e kryer në vitin 2021, ku vetëm 30% e të anketuarve e kuptonin gjuhën e urrejtjes - një rritje prej 20% krahasuar me studimin e mëparshëm.** Rritja e ndërgjegjësimit gjatë katër viteve të fundit tregon një tendencë pozitive në të kuptuarit dhe njohjen e gjuhës së urrejtjes mes kësaj popullate në rrezik.

Figura 11 Niveli i njohurisë për gjuhën e urrejtjes mes mostrës shtesë



Atyre që u përgjigjën “po” në pjesën e parë ju drejtua një pyetje e hapur duke u përqendruar në kategoritë kryesore për të vlerësuar saktësinë e të kuptuarit prej tyre të gjuhës së urrejtjes. Shumica, 41%, e lidhën termin me ofendimin e të tjerëve, ndërsa 19% e lidhën atë me urrejtje ndaj grupeve të ndryshme. Përveç kësaj, 16% e identifikuan atë me denigrimin racor dhe 14% e lidhën atë me diskriminimin. Të anketuarit e mbetur e lidhën gjuhën e urrejtjes me terma të tillë si përbuzje, urrejtje bazuar në etni, urrejtje ndaj individëve dhe urrejtje për arsye seksuale, mes të tjerave (shih Fig. 16). Shumë nga këto lidhje nuk korrespondojnë plotësisht me përkufizimin ligjor të gjuhës së urrejtjes. Kjo tregon se edhe pse ndërgjegjësimi për termin është i përhapur, thellësia e të kuptuarit është e kufizuar ose e pasaktë për një pjesë të konsiderueshme të të anketuarve, duke nënvizuar nevojën për edukim të mëtejshëm dhe fushata ndërgjegjësimi publik.


Figura 12. Të anketuarit nga mostra shtesë që u përgjigjën “po”: Çfarë kuptojnë ata me termin “gjuha e urrejtjes”

Category	Percentage
To offend	41%
Unethical, derogatory language that incites hatred against various groups.	19%
Hatred, discrimination, denigration on racial grounds	16%
Discrimination	14%
Contempt	11%
Language that promotes physical and psychological violence	8%
To hate someone	8%
Bullying	7%
Hatred because of appearance	6%
Hatred, discrimination, denigration on sexual grounds	6%
Hatred, discrimination, denigration based on religion	6%
Hatred, discrimination, denigration on ethnic grounds	5%
Anger towards someone/envy	4%
To speak badly about someone	2%
Hatred, discrimination, gender-based denigration	2%
Prejudices	2%
Other	4%

### 3.3 PERCEPTIME PËR GJUHËN E URREJTJES

Të anketuarve iu kërkua të jepnin mendimet e tyre mbi përhapjen e gjuhës së urrejtjes në vend. Të dhënat tregojnë se perceptimet në lidhje me përhapjen e gjuhës së urrejtjes kanë mbetur kryesisht të pandryshuara krahasuar me katër vite më parë. Koncretisht, **17% besojnë se gjuha e urrejtjes është e përhapur në një masë të (vogël), afërsisht 21% mendojnë se është e përhapur në një masë të moderuar dhe 61% e perceptojnë atë si të përhapur ose shumë të përhapur.** Vetëm 1% e të anketuarve nuk ishin të sigurt për përhapjen e gjuhës së urrejtjes në vend.


Figura 13. Për mendimin tuaj, sa e përhapur është gjuha e urrejtjes në Shqipëri? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë



**Perceptimet e përhapjes së gjuhës së urrejtjes në Shqipëri variojnë sipas grup-moshës.** Personat mbi 50 vjeç, të cilët tregojnë ndërgjegjësim më të madh për gjuhën e urrejtjes, kanë më shumë gjasa të besojnë se ajo është e përhapur në vend, me 66% që ndajnë këtë mendim. Nga ana tjetër, 61% e atyre të moshës 18-29 vjeç kanë të njëjtën bindje, dhe 56% e grupmoshës 30-49 vjeç e perceptojnë gjuhën e urrejtjes si të përhapur në një masë të madhe. Kjo nxjerr në pah një ndryshim të dukshëm në perceptime mes këtyre kategorive të

moshave. Duhet theksuar se këto shifra i referohen të gjithë të anketuarve në secilën grupmoshë, dhe jo vetëm atyre që janë tashmë të vetëdijshëm për gjuhën e urrejtjes. Rezultatet sipas gjinisë tregojnë dallime minimale në perceptime.


Figura 14. Për mendimin tuaj, sa e përhapur është gjuha e urrejtjes në Shqipëri? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas moshës:



Gjithashtu, të anketuarve iu kërkua të identifikonin se cilat programe televizive ata besojnë se kontribuojnë në përhapjen e gjuhës së urrejtjes. **Debatet politike ishin programet më të përmendura nga** mostra e popullsisë së përgjithshme, në përputhje me gjetjet e anketës së vitit 2021. Megjithatë, është ulur përqindja e të anketuarve që përmendën këto programe; në vitin 2021, 7 nga 10 qytetarë përmendën debatet politike, ndërsa tani është pothuajse 6 nga 10.

Pas debateve politike, kanë fituar epërsi **programet e realitetit**, me 55% të të anketuarve që i identifikojnë ato si kontribues të gjuhës së urrejtjes, duke shënuar një rritje prej 9% që nga anketa e fundit. Në vendin e tretë, me një hendek të dukshëm, janë **programet e përgjithshme**. Ky ndryshim në perceptim sugjeron qëndrime në zhvillim ndaj llojeve të ndryshme të programeve dhe rolit të tyre të mundshëm në promovimin e gjuhës së urrejtjes. Ulja e perceptimit për debatet politike, së bashku me rritjen e shqetësimeve në lidhje me programet e realitetit nxjerr në pah një peizazh dinamik në ndikimin e medias te qëndrimet shoqërore.


Figura 15. Për mendimin tuaj, cilat programe televizive (nëse ka) kanë më shumë gjasa të përhapin Gjuhën e Urrejtjes te ndjekësit e tyre? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë



**Ka dallime të dukshme në perceptimet sipas gjinisë. Meshkujt** kanë tendencë t'i shohin **debatet politike** si më të prirura për të përhapur gjuhën e urrejtjes në Shqipëri (**63%**), **ndërsa femrat** janë më të prirura të besojnë se **programet e realitetit** kontribuojnë në këtë çështje, **me 66%** që shprehin këtë pikëpamje. Përveç kësaj, ka dallime në opinion për programet e përgjithshme. Pothuajse 33% e burrave besojnë se këto programe përhapin gjuhën e urrejtjes, duke i renditur ato si programi i tretë më i mundshëm për ta bërë këtë. Ndërsa, 47% e femrave i identifikojnë programet e përgjithshme si kontribues të mundshëm të gjuhës së urrejtjes.

Në përgjithësi, opinionet në lidhje me llojet e tjera të programeve, siç janë programet e mbrëmjes, telenovelat, filmat dhe reklammat, janë relativisht njësoj për të anketuarit sipas gjinisë. Kjo nxjerr në pah perspektiva të ndryshme mbi zhanre specifike, ndërsa tregon një pikëpamje më të unifikuar për të tjerat.


Figura 16 Për mendimin tuaj, cilat programe televizive (nëse ka) kanë më shumë gjasa të përhapin Gjuhën e Urrejtjes te ndjekësit e tyre? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas seksit



**Grupmosha** të ndryshme kanë pikëpamje të dallueshme mbi atë që besojnë se kontribuon më shumë në përhapjen e gjuhës së urrejtjes. Në përputhje me gjetjet e anketës së mëparshme, të anketuarit më të rinj kanë më shumë gjasa të identifikojnë programet e realitetit si kontribuesit kryesorë të gjuhës së urrejtjes, me 69% të atyre të moshës 18-29 vjeç dhe 66% të atyre të moshës 30-49 vjeç që ndajnë këtë këndvështrim. Në kontrast të plotë, vetëm 35% e të anketuarve të moshës 50-64 vjeç ndihen njësoj.


Anasjelltas, grupmoshat më të vjetra kanë tendencë t'i shohin programet politike si burimin kryesor të gjuhës së urrejtjes. Përveç kësaj, më të moshuarit konsiderojnë programet e lajmeve të mbrëmjes si kontribues të rëndësishëm, me 69% të atyre të moshës 50-64 vjeç që i identifikojnë kështu. Kjo krahasohet me vetëm 49% të të anketuarve të moshës 18-29 vjeç dhe 53% të atyre të moshës 30-49 vjeç që i atribuojnë të njëjtin nivel ndikimi programeve politike. Kjo ndarje brezash në perceptime nxjerr në pah se si moshja ndikon në qëndrimet ndaj llojeve të ndryshme të medias. Më të rinjtë janë më të prirur të lidhin programet e realitetit me gjuhën e urrejtjes, duke reflektuar një tendencë kulturore në konsumin e tyre mediatic, ndërsa të anketuarit më të vjetër përqendrohen në formatet më tradicionale të lajmeve dhe diskursin politik si kontribues kryesorë të gjuhës së urrejtjes në shoqëri.

Figura 17. Për mendimin tuaj, cilat programe televizive (nëse ka) kanë më shumë gjasa të përhapin Gjuhën e Urrejtjes te ndjekësit e tyre? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas moshës



Dallimet në perceptime janë gjithashtu të dukshme bazuar në vendbanimin urban kundrejt atij rural. **Personat që jetojnë në zona urbane ka më shumë gjasa t'i konsiderojnë programet e realitetit si programet kryesore televizive që kontribuojnë në përhapjen e gjuhës së urrejtjes**, me 66% që e kanë këtë bindje. Nga ana tjetër, **ata nga zonat rurale kanë tendencë t'i shohin programet politike** si burimin kryesor të gjuhës së urrejtjes (64%). Kjo divergjencë nxjerr në pah se si konteksti gjeografik mund të ndikojë në opinionet mbi median dhe ndikimin e saj në qëndrimet shoqërore.

Figura 18 Për mendimin tuaj, cilat programe televizive (nëse ka) kanë më shumë gjasa të përhapin Gjuhën e Urrejtjes te ndjekësit e tyre? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas vendndodhjes urbane-rurale




Të anketuarve iu kërkua të identifikonin motivet më të zakonshme pas përdorimit të gjuhës së urrejtjes, me mundësinë për të zgjedhur përgjigje të shumëfishta. Të dhënat tregojnë se **frika ose fobia ndaj komunitetit LGBTI+ (44%), e ndjekur nga çështjet që lidhen me statusin social dhe varfërinë ose mungesën e strehimit ishin motivet më të përmendura**, ku secila është përmendur nga 42% e pjesëmarrësve. Origjina etnike ishte gjithashtu një faktor i rëndësishëm, me 40% të të anketuarve që e tregojnë atë si motiv. Pamja fizike, raca dhe bindja politike përmenden përkatësisht nga 37%, 34% dhe 32% e të anketuarve të anketës këtë vit.

**Kur krahasohen këto gjetje me anketën e vitit 2021, dalin në pah dallime të dukshme.** Në atë anketë të mëparshme, varfëria u rendit si motivi kryesor i identifikuar nga 54% e të anketuarve, ndërsa statusi social, pamja fizike dhe bindja politike u renditën në vend të dytë me 44%, duke reflektuar një hendek prej 10% nga motivi kryesor. Veçanërisht, homo-bi-lesbo-transfobia u rendit më poshtë, me 41%.

**Për më tepër, ka pasur një rënie të ndjeshme në perceptimin e opinionit politik si motiv për gjuhën e urrejtjes, me një rënie prej 12% që nga anketa e fundit. Pamja fizike gjithashtu ka pësuar ulje prej 7% në rolin e saj të perceptuar si shkaktar për gjuhën e urrejtjes.** Këto ndryshime nxjerrin në pah qëndrimet shoqërore në zhvillim dhe peizazhin në ndryshim të faktorëve që kontribuojnë në gjuhën e urrejtjes.

Figura 19. Për mendimin tuaj, cili është motivi më i zakonshëm që shkakton Gjuhën e Urrejtjes Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë.



### Të dhënat zbulojnë dallime të rëndësishme në motivet për gjuhën e urrejtjes mes grupmoshave të ndryshme.

Të anketuarit më të rinj më shpesh e identifikojnë homo-bi-lesbo-transfobinë si motivin kryesor për gjuhën e urrejtjes me të cilën përballen. Nga ana tjetër, të anketuarit më të vjetër e perceptojnë më shpesh gjuhën e urrejtjes si të drejtuar ndaj individëve për shkak të statusit të tyre shoqëror ose varfërisë. Kjo tregon se si moshë ndikon në perceptimet për grupet që janë më në shënjestër të gjuhës së urrejtjes.

Është interesante që të anketuarit më të rinj ka më shumë gjasa të raportojnë se hasen me gjuhën e urrejtjes të motivuar nga përkatësia etnike krahasuar me ata mbi 50 vjeç. Përveç kësaj, **pamja fizike është gjithashtu një faktor më i spikatur për personat e moshës 18-29 vjeç**, ku gjysma e këtij grupi e identifikon atë si një arsye për gjuhën e urrejtjes. Kjo bie ndesh ndjeshëm me vetëm 37% të atyre të moshës 30-49 vjeç dhe vetëm 28% të të anketuarve të moshës 50-64 vjeç që e perceptojnë pamjen fizike si një faktor motivues në gjuhën e urrejtjes sipas vëzhgimit prej tyre.

Këto gjetje nxjerrin në pah perspektivat e ndryshme mes grupmoshave në lidhje me shkaqet themelore të gjuhës së urrejtjes, duke sugjeruar që **më të rinjtë mund të jenë më të orientuar ndaj çështjeve bashkëkohore sociale, ndërsa të anketuarit më të vjetër përqendrohen në faktorët tradicionalë socio-ekonomikë.**

### Rezultatet tregojnë dallime të dukshme në mënyrën se si burrat dhe gratë i perceptojnë motivet që qëndrojnë pas gjuhës së urrejtjes.

- Për burrat, shkaktarët kryesorë të gjuhës së urrejtjes që ata vëzhgojnë janë varfëria/mungesa e strehimit (49%) dhe statusi shoqëror (47%).
- Nga ana tjetër, gratë përmendin homo-bi-lesbo-transfobinë si shkakun kryesor (49%), të ndjekur nga etnia me 43%, ndërsa shqetësimi i burrave për etninë është më i ulët në 37%. Përveç kësaj, gratë theksojnë si shkak pamjen fizike (40%), ndërsa te burrat ky shkak qëndron në nivelin 33%.


Figura 20 Perceptimet e të anketuarve për shkaqet më të zakonshme që motivojnë gjuhën e urrejtjes, sipas seksit.



### Dallimet në perceptime bazuar në vendndodhjen urbane rurale janë gjithashtu të dukshme


- Banorët e zonave urbane identifikojnë fobitë që lidhen me komunitetin LGBTI+ (53%) dhe përkatësinë etnike (47%) si motivet kryesore për gjuhën e urrejtjes që ata kanë vërejtur.
- Përkundrazi, banorët e zonave rurale kanë më shumë gjasa t'ia atribuojnë gjuhën e urrejtjes varfërisë (51%) dhe statusit shoqëror (50%). Ky kontrast tregon se si konteksti gjeografik ndikon në faktorët e perceptuar të gjuhës së urrejtjes.

Figura 21 Për mendimin tuaj, cili është motivi më i zakonshëm që shkakton Gjuhën e Urrejtjes, sipas grupmoshës dhe vendndodhjes urbane-rurale. Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë



**Kur u pyetën për llojet e shprehjeve që mund të klasifikohen si gjuhë urrejtjeje, afërsisht 69% dhe 67% e të anketuarve identifikuan përkatësisht nxitjen e urrejtjes dhe dëmtimin e reputacionit (shpifjen) përkatësisht si forma të gjuhës së urrejtjes. Përveç kësaj, 63% i konsideruan sulmet verbale si gjuhë urrejtjeje. Këto gjetje tregojnë një ndryshim të lehtë nga anketa e vitit 2021, ku shpifja u njoh si forma kryesore e gjuhës së urrejtjes nga tre të katërtat e të anketuarve, e ndjekur nga nxitja e urrejtjes. Edhe pse si nxitja e urrejtjes ashtu edhe shpifja mbeten dy format kryesore të identifikuara të gjuhës së urrejtjes, ato u përmendën më rrallë në anketën e fundit. Rezultatet sipas gjinisë tregojnë dallime minimale në perceptime.**

Figura 22. Cilat forma të mëposhtme të të shprehurit mund të etiketohen si Gjuhë e Urrejtjes. Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë



**Rezultatet sipas grupmoshës tregojnë se shpifja shihet si një formë e rëndësishme e gjuhës së urrejtjes, veçanërisht mes individëve më të moshuar 50-64 vjeç, në përputhje me gjetjet e anketës së mëparshme. Përkundrazi, për më të rinjtë të moshës 18-29 vjeç, poshtërimi për shkak të pamjes fizike shfaqet si shprehja më shpesh e cituar e identifikuar si gjuhë e urrejtjes.**

**Rezultatet sipas urbanizimit zbulojnë disa ndryshime në perceptime.** Banorët urbanë e shohin nxitjen e urrejtjes si formën kryesore të shprehjes së klasifikuar si gjuhë e urrejtjes, të ndjekur nga shpifja dhe fyerjet/ofendimet etnike. Përkundrazi, banorët ruralë e rendisin shpifjen si më të rëndësishmen, të ndjekur nga kërcënimet, nxitja e urrejtjes dhe sulmet verbale.

Figura 23. Për mendimin tuaj, cila forma të mëposhtme të të shprehurit mund të etiketohen si Gjuhë e Urrejtjes. Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas moshës





Figura 24 Për mendimin tuaj, cila forma të mëposhtme të të shprehurit mund të etiketohen si Gjuhë e Urrejtjes. Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas vendndodhjes urbane-rurale




Të anketuarit u pyetën gjithashtu rreth përvojave të individëve ose grupeve që janë objekt i gjuhës së urrejtjes. Njësoj si me anketën e mëparshme, **ankthi, depresioni dhe dhimbja emocionale u identifikuan si rezultate të zakonshme.**

**Vlen të përmendet se këto ndjenja u raportuan dukshëm më shpesh nga gratë se nga burrat:**


- 62% e grave treguan se humbja e besimit ndihet nga ata që janë në shënjestër, krahasuar me vetëm 40% të burrave.
- Dhimbja emocionale tregoi një pabarazi të ngjashme, me 45% të burrave dhe 65% të grave që e pranonin ndikimin e saj.
- Përveç kësaj, 29% e burrave dhe 47% e grave përmendën ndjesinë e kërcënimit, duke theksuar më tej dallimet gjinore në perceptimet e efekteve të gjuhës së urrejtjes tek ata që janë objekt i saj.

Figura 25. Cilat nga sa më poshtë mund të përjetojë një person/grup që është objekt i gjuhës së urrejtjes, Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas seksit.




Rezultatet sipas grupmoshës tregojnë se **të anketuarit e rinj (mosha 18-29 vjeç) kanë më shumë gjasa të perceptojnë se gjuha e urrejtjes çon në humbjen e besimit mes atyre që janë objekt i saj, me 71% që e pranojnë këtë ndikim**, në përputhje me gjetjet e anketës së vitit 2021. Nga ana tjetër, **të anketuarit më të vjetër (mosha 50-64 vjeç) e perceptojnë më shpesh ankth dhe depresionin si pasojë të gjuhës së urrejtjes tek ata që janë objekt i saj**, me 6 nga 10 persona që tregojnë këtë ndikim krahasuar me grupmoshat e tjera.

Figura 26. Cilat nga përgjigjet e mëposhtme mund të përjetojë një person/grup që është objekt i gjuhës së urrejtjes. Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas grupmoshës




Të anketuarve iu kërkua të identifikonin kontekstet ku ata besojnë se gjuha e urrejtjes përjetohet më shpesh në vend, me mundësinë për të zgjedhur kontekste të shumëfishta. Njësoj si me valën e mëparshme të studimit, **rreth 6 nga 10 të anketuar treguan që mediat sociale janë mjedisi kryesor për gjuhën e urrejtjes**. Përafërsisht 56% besojnë se shkollat dhe universitetet janë gjithashtu mjedise të rëndësishme ku individët mund të hasin gjuhën e urrejtjes. Rreth gjysma e të anketuarve identifikuan vendet e punës si një mjedis tjetër, megjithëse kjo shifër është 8% më e ulët se në studimin e vitit 2021. Kontekste të tjera, të tilla si bisedat private, zyrat publike, transporti, sportet dhe platformat e transmetimit, u përmendën më rrallë krahasuar me vitin 2021, veçanërisht ligjërimi politik, i cili pa një rënie prej 13% në njohjen e tyre.

Figura 27. Ku/në cilin kontekst mund të përjetohet më shumë gjuha e urrejtjes në Shqipëri? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë



Ka disa dallime sipas grupmoshës në lidhje me kontekstet ku perceptohet gjuha e urrejtjes. Të anketuarit e moshës 18-29 vjeç identifikojnë kryesisht shkollat dhe universitetet si mjedisin kryesor, të ndjekura nga mediat sociale, ndërsa ata të moshës 39-49 vjeç rendisin të parën median sociale. Kjo tendencë mund të tregojë që të anketuarit më të rinj janë ende në shkollë ose kanë përfunduar së fundmi arsimin. Përveç kësaj, ka dallime të lehta mes grupmoshave për kontekste të tjera, veçanërisht në ligjërimin politik, i cili njihet më shumë nga të anketuarit më të vjetër (45%) krahasuar me ata më të rinj (18%). Nuk u gjetën dallime të rëndësishme në përgjigjet sipas vendndodhjes urbane-rurale.


Figura 28. Ku/në cilin kontekst mund të përjetohet më shumë gjuha e urrejtjes në Shqipëri? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas grupmoshës



### 3.3 PERCEPTIME PËR GJUHËN E URREJTJES NGA KOMUNITETET LGBTI+ DHE ROM/EGJIPTIAN


**LGBTI** Të dhënat rreth shkallës në të cilën gjuha e urrejtjes perceptohet si e përhapur në Shqipëri tregojnë një ndërgjegjësime më të lartë mes komunitetit LGBTI+ (84%) krahasuar me komunitetin rom/egjiptian (47%). Ky ndryshim mund të lidhet me dallimet në ekspozimin dhe kontekstin shoqëror. Për shembull, të anketuarit rom mund të përjetojnë gjuhën e urrejtjes aq shpesh sa që normalizohet dhe ka më gjasa të identifikohet si e tillë, ndërsa të anketuarit LGBTI+ mund të kenë mundësi më të mëdha përmes mbështetjes dhe mbrojtjes së komunitetit për t'i përkufizuar këto përvoja në mënyrë të qartë si gjuhë e urrejtjes.

Figura 29. Për mendimin tuaj, sa e përhapur është gjuha e urrejtjes në Shqipëri? Përgjigje të mostrës shtesë të komuniteteve LGBTI++ dhe Rom/Egjiptian



Kur u pyetën në lidhje me kanalet përmes të cilave përhapet gjuha e urrejtjes, si komuniteti LGBTI+ ashtu edhe ai rom/egjiptian identifikuan televizionin si burimin kryesor. Mes të anketuarve LGBTI+, 76% identifikuan programet e realitetit dhe programet e përgjithshme, ndërsa 51% e të anketuarve rom theksuan programet e përgjithshme si burimin kryesor. Kjo sugjeron një dakordësim të gjerë që programet televizive luajnë një rol të madh në përhapjen e gjuhës së urrejtjes, edhe pse ndryshimet në modelet e konsumit të medias mund të ndikojnë në formatet që theksohen.


Figura 30. Cilat programe televizive kanë më shumë gjasa të përhapin Gjuhën e Urrejtjes? Përgjigje të mostrës shtesë të komuniteteve LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian



Të anketuarit në grupin që përfaqësonin ata që objekt i gjuhës së urrejtjes u pyetën gjithashtu rreth arsyeve më të zakonshme që motivonin gjuhën e urrejtjes të vërejtura prej tyre. Kjo anketë synon të mbledhë informacion mbi të kuptuarin e gjuhës së urrejtjes. **Ashtu si në anketën e fundit në vitin 2021, faktori më i rëndësishëm i identifikuar mes komunitetit LGBTI+ është homofobia**, e përmendur nga 82%. Arsyet e tjera që motivojnë gjuhën e urrejtjes përfshijnë përkatësinë etnike, frikën nga gratë (mizogjininë) dhe pamjen fizike, secila e përmendur nga rreth gjysma e të anketuarve. Përveç kësaj, raca dhe bindjet politike vërehen si faktorë që kontribuojnë në gjuhën e urrejtjes.

**Nga ana tjetër, ashtu si në vitin 2021**, komuniteti rom percepton racën dhe përkatësinë etnike si shkaktarë kryesorë për gjuhën e urrejtjes, të ndjekur nga pamja fizike, raca dhe përkatësia etnike. Ata gjithashtu e konsiderojnë varfërinë dhe mungesën e strehimit si arsye për gjuhën e urrejtjes, me 41% që e identifikojnë këtë çështje - dukshëm më e lartë se 28% e identifikuar nga komuniteti LGBTI+.


Figura 31. Cili është motivi më i zakonshëm që shkakton Gjuhën e Urrejtjes? Përgjigje të mostrës shtesë të komuniteteve LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian



Një pyetje tjetër e rëndësishme trajton format e shprehjes që mund të klasifikohen si gjuhë e urrejtjes:


- **87%** e komunitetit LGBTI+ beson se stereotipet rreth tyre përbëjnë gjuhë urrejtjeje, ndërsa **65%** e komunitetit rom i konsideron fyerjet dhe sharjet etnike si gjuhë urrejtjeje. Përveç kësaj, **52%** e komunitetit rom i konsideron shakatë për pakicat etnike si gjuhë urrejtjeje, dhe **41%** e konsiderojnë nxitjen e urrejtjes në të njëjtën mënyrë.
- Mes komunitetit LGBTI+, nxitja e urrejtjes, sulmet verbale dhe shakatë për gratë identifikohen si forma të rëndësishme të gjuhës së urrejtjes nga tre nga katër pjesëmarrës në studim.

Figura 32. Cilat forma të mëposhtme të të shprehurit mund të etiketohen si Gjuhë e Urrejtjes? Përgjigje të mostrës shtesë të komuniteteve LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian



Komuniteti rom beson se individët që janë objekt i gjuhës së urrejtjes ka të ngjarë të përjetojnë dhimbje emocionale dhe ndjenjë turpi. Përkundrazi, komuniteti LGBTI+ beson se të qenit objekt i gjuhës së urrejtjes i bën ata që të ndihen të kërcënuar dhe të përjetojnë ankth dhe depresion.


Figura 33. Cilat nga emocionet e mëposhtme mund të përjetojë një person/grup që është objekt i gjuhës së urrejtjes? Përgjigje të mostrës shtesë të komuniteteve LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian



### 3.4 PËRVOJA ME GJUHËN E URREJTJES


Pjesa tjetër e anketës u përqendrua në përvojat e të anketuarve të popullsisë së përgjithshme me gjuhën e urrejtjes. Pas vlerësimit të perceptimeve dhe njohurive të tyre, anketa synoi të sqaronte se si përjetohet ky fenomen në vend. Të anketuarit u pyetën nëse kishin hasur së fundmi gjuhën e urrejtjes, qoftë personalisht apo në lidhje me të tjerët. Rezultatet tregojnë se **afërsisht 57% nuk kanë përjetuar gjuhën e urrejtjes as personalisht dhe as nuk kanë dëgjuar për të tjerë që e kanë përjetuar**, duke shënuar një rënie të lehtë nga 61% në anketën e vitit 2021. Rreth një në tre të anketuar raportuan se kishin dëgjuar që të tjerët përreth tyre kishin përjetuar gjuhën e urrejtjes, ndërsa rreth 14% deklaruan se e kishin hasur personalisht. Këto dy shifra të fundit janë pothuajse në përputhje me valën e mëparshme të studimit, me ndryshime të vogla brenda kufirit të gabimit (përkatësisht 32% dhe 14%).

Figura 34. A keni dëgjuar ose a jeni ekspozuar ju personalisht apo persona të tjerë së fundmi me Gjuhën e Urrejtjes? Përgjigje të mostrës së publikut të gjerë




Rezultatet sipas gjinisë nuk zbulojnë dallime të rëndësishme, ndërsa gjetjet në lidhje me moshën tregojnë se të anketuarit më të rinj kanë më pak gjasa të jenë ekspozuar ose të kenë dëgjuar për gjuhën e urrejtjes ndaj të tjerëve përreth tyre krahasuar me të anketuarit më të moshuar.

Figura 35. A keni dëgjuar ose a jeni ekspozuar ju personalisht apo persona të tjerë së fundmi me Gjuhën e Urrejtjes? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas grupmoshës.




Për më tepër, të anketuarit u pyetën nëse kishin ndërmarrë ndonjë masë pasi kishin qenë dëshmitarë të gjuhës së urrejtjes ndaj dikujt tjetër. **Rezultatet tregojnë se gjysma e të anketuarve vepruan**, në përputhje me gjetjet e anketës së mëparshme. Rreth 16% nuk ndërmorën asnjë masë, ndërsa 22% shprehën dëshirën për të ndërhyrë, por nuk ishin të sigurt se si të vepronin.

Figura 36. Në rast se keni qenë dëshmitar i gjuhës së urrejtjes të përdorur ndaj dikujt tjetër, a keni marrë ndonjë masë? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë




Gjithashtu, të anketuarit që raportuan se kishin vepruar pasi kishin qenë dëshmitarë të gjuhës së urrejtjes drejtuar të tjerëve u analizuan sipas moshës dhe urbanitetit, duke treguar dallimet në të dyja kategoritë. **Të anketuarit më të vjetër duket se kanë ndërmarrë më shumë masa se ata më të rinj**, me 68% të atyre të moshës 50 vjeç e lart që raportuan se kishin ndërhyrë, krahasuar me 48% të atyre të moshës 30-49 vjeç dhe vetëm 37% të të anketuarve të moshës 18-29 vjeç.

Figura 37. Në rast se keni qenë dëshmitar i gjuhës së urrejtjes të përdorur ndaj dikujt tjetër, a keni marrë ndonjë masë? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas grupmoshës.



Të anketuarit në anketën e përgjithshme u pyetën për përvojat e tyre personale me gjuhën e urrejtjes në internet. Rezultatet tregojnë se **76% nuk kanë hasur kurrë ngjarje të gjuhës së urrejtjes**, gjë që është e ngjashme me rezultatet e anketës së vitit 2021 (80%). Përafërsisht 10% raportuan se janë ekspozuar disa herë, ndërsa 7% deklaruan se e kanë përjetuar shumë shpesh. Përveç kësaj, rreth 8% thanë se nuk e dinin. Rezultatet sipas gjinisë tregojnë se disi më pak burra krahasuar me gratë nuk janë ekspozuar kurrë ndaj gjuhës së urrejtjes.


Figura 38. A keni qenë ndonjëherë të ekspozuar ndaj Gjuhës së Urrejtjes në internet? Publiku i gjerë.



**Të dhënat sipas grupmoshës tregojnë se më të rinjtë kanë më shumë gjasa të përballen me gjuhën e urrejtjes.**

Rreth 20% e të anketuarve të moshës 18-29 vjeç raportojnë se janë ekspozuar të paktën disa herë, krahasuar me rreth 10% të të anketuarve më të vjetër. Ndërsa dallimi është modest, ai sugjeron që të rinjtë ekspozohen më shpesh, ndoshta për shkak të përdorimit më të madh të platformave online.

Figura 39. A keni qenë ndonjëherë të ekspozuar ndaj Gjuhës së Urrejtjes në internet? sipas grupmoshës. Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë




Të anketuarit që kanë hasur gjuhën e urrejtjes në internet u pyetën për veprimet e tyre të mëvonshme. **Në anketën e mëparshme, një pjesë e konsiderueshme (39%) zgjodhi ta injoronte atë plotësisht, ndërsa këtë vit, 37% raportuan se e kanë fshirë mesazhin e gjuhës së urrejtjes dhe e kanë hequr personin nga lista e miqve ose e kanë bllokuar**, pra kjo tregon një përgjigje proaktive krahasuar me vitin 2021. Megjithatë, një përqindje e konsiderueshme prej 34% zgjodhi të mos ndërmerre asnjë masë.

Gjithashtu, një përqindje e vogël e të anketuarve komunikoi drejtpërdrejt me personin që e sulmoi ose kërkoi këshillë nga të tjerët.

**Kur bëhet fjalë për raportimin, vetëm 13% treguan se e raportuan incidentin në platformën e medias sociale**, një rritje e lehtë nga 11% në vitin 2021. Është e rëndësishme të theksohet se **shumë pak individë i raportuan këto incidente në polici (3%) ose kërkuan ndihmë nga një avokat ose Komisioneri kundër Diskriminimit, me vetëm 1% për secilën për këto mundësi**. Veçanërisht, askush nuk i raportoi incidentet në ndonjë shoqatë të shoqërisë civile. **Në përgjithësi, ndërsa është i dukshëm një farë progresi në reagime, një numër i konsiderueshëm personash ende zgjedhin të mos marrin masa ose të mos ndjekin rrugë zyrtare raportimi.**


Figura 40. Në rast se keni qenë të ekspozuar ndaj gjuhës së urrejtjes në internet, çfarë keni bërë? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë



Rezultatet sipas gjinisë tregojnë se **gratë kanë më shumë gjasa të veprojnë** pas përjetimit të gjuhës së urrejtjes në internet. Gratë janë më proaktive, me 35% që zgjedhin të fshijnë mesazhin e gjuhës së urrejtjes dhe ta heqin nga lista e miqve ose ta bllokojnë autorin. Përveç kësaj, gratë kanë më shumë gjasa të reagojnë duke komunikuar me sulmuesin (23%), duke kërkuar këshilla nga të tjerët (18%), ose duke raportuar incidentin në një platformë të medias sociale (15%).

Kur analizohen rezultatet sipas moshës, nuk ka shumë ndryshime; shumica e individëve, pavarësisht moshës, ose nuk bëjnë asgjë ose zgjedhin ta fshijnë mesazhin e urrejtjes.

Figura 41. Në rast se keni qenë të ekspozuar ndaj gjuhës së urrejtjes në internet, çfarë keni bërë? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas gjinisë.



### 3.4.1 Përvoja e komunitetit LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian me gjuhën e urrejtjes

Disa nga pyetjet e anketës përqendrohen në përvojat e të anketuarve me gjuhën e urrejtjes. Pjesëmarrësit u pyetën nëse kanë dëgjuar së fundmi ose janë ekspozuar personalisht ndaj gjuhës së urrejtjes, qoftë drejtpërdrejt ose të tjerët. **Rezultatet janë në përputhje me anketën e vitit 2021: shumica e komunitetit LGBTI+ raporton se është ekspozuar personalisht ose ka dëgjuar për të tjerët që janë përballur me gjuhën e urrejtjes kohët e fundit.**

Nga ana tjetër, situata për komunitetin rom ka ndryshuar pak që nga viti 2021. Tani, më pak individë (37%) raportojnë se kanë përjetuar personalisht gjuhën e urrejtjes, nga 45% në vitin 2021. Megjithatë, ka një rritje të atyre që kanë dëgjuar se të tjerët janë ekspozuar ndaj gjuhës së urrejtjes. Rrjedhimisht, përqindja e njerëzve që thonë se nuk kanë dëgjuar dhe as nuk kanë përjetuar gjuhën e urrejtjes mbetet e njëjtë me vitin 2021, në 35%.

Figura 42 A keni dëgjuar ose a jeni ekspozuar ju personalisht apo persona të tjerë së fundmi me Gjuhën e Urrejtjes? Përgjigje të mostrës shtesë të komuniteteve LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian






Figura 43 A keni dëgjuar ose a jeni ekspozuar ju personalisht apo persona të tjerë së fundmi me Gjuhën e Urrejtjes? Përgjigje të mostrës shtesë të komuniteteve LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian



Një pyetje tjetër e rëndësishme, e drejtuar në mënyrë specifike atyre që kanë përjetuar personalisht ose kanë dëgjuar gjuhën e urrejtjes, eksploron gatishmërinë e tyre për të vepruar kur të tjerët preken. **Komuniteti LGBTI+ tregon një qëndrim proaktiv, me 62% që deklarojnë se kanë vepruar**, megjithëse 25% pranojnë se nuk janë të sigurt se si të reagojnë në këto situata.

Nga ana tjetër, **përgjigjet e komunitetit rom janë më të ndara**. Rreth një e treta raportojnë se kanë ndërmarrë masa, një e treta tjetër thonë se nuk kanë ndërmarrë masa, dhe një e treta e mbetur shpreh pasiguri për atë që duhet bërë. Kjo ndarje sugjeron mungesë konsensusi ose qartësie brenda komunitetit rom në lidhje me përgjigjet e duhura ndaj gjuhës së urrejtjes, duke nxjerrë në pah një fushë potenciale për edukim dhe mbështetje të mëtejshme.


Figura 44. Në rast se keni qenë dëshmitar i gjuhës së urrejtjes të përdorur ndaj dikujt tjetër, a keni marrë ndonjë masë? Përgjigje të mostrës shtesë të komuniteteve LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian



Gjithashtu, të anketuarve iu kërkua të flisnin për përvojat e tyre me gjuhën e urrejtjes në internet. **Në përputhje me gjetjet e vitit 2021, rezultatet tregojnë se një pjesë më e madhe e komunitetit LGBTI është ekspozuar ndaj gjuhës së urrejtjes në internet krahasuar me komunitetin rom, me 36% të individëve LGBTI+ që raportojnë ekspozim të shpeshtë kundrejt 23% të komunitetit Rom.**

Kjo diferencë sugjeron që gjuha e urrejtjes në internet mund të jetë më e përhapur ose më e dukshme mes komunitetit LGBTI+, duke nxjerrë në pah sfidat e vazhdueshme me të cilat përballen në hapësirat digjitale. Përqindja më e ulët mes komunitetit rom mund të tregojë ose më pak ekspozim ose një ndryshim në mënyrën se si individët raportojnë ose njohin gjuhën e urrejtjes në internet. Një eksplorim i mëtejshëm i këtyre dinamikave mund të ofrojë njohuri të vlefshme mbi përvojat e të dy komuniteteve në kontekstin e ngacmimit digjital.

Figura 45. A keni qenë ndonjëherë të ekspozuar ndaj Gjuhës së Urrejtjes në internet? Përgjigje të mostrës shtesë të komuniteteve LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian




Pjesëmarrësve iu kërkua gjithashtu të tregonin masat që kishin marrë kur ishin përballur me gjuhën e urrejtjes në internet. Përafërsisht 30% e komunitetit LGBTI+ raportuan se nuk kanë bërë gjë, kanë fshirë mesazhin e urrejtjes ose thjesht e kanë denoncuar tek ofruesi i medias sociale. Kjo tregon një **tendencë të vogël mes komunitetit LGBTI+ për të ndërmarrë masa proaktive**, pasi 15% zgjodhën ta raportonin incidentin në një organizatë të shoqërisë civile, krahasuar me vetëm 8% të komunitetit rom.

Nga ana tjetër, 29% e komunitetit rom ose nuk ka bërë asgjë ose e ka fshirë mesazhin, që është pak më e lartë se 26% në grupin LGBTI+. Veçanërisht, 21% e komunitetit rom u përgjigj që komunikoi drejtpërdrejt me personin që i sulmoi, një përgjigje e raportuar më shpesh se nga komuniteti LGBTI+, ku vetëm 12% ndërmorën masa të ngjashme.

**Këto të dhëna tregojnë një qasje kontradiktore për trajtimin e gjuhës së urrejtjes në internet mes dy komuniteteve. Komuniteti LGBTI+ tregon një prirje më të fortë për të raportuar incidentet tek organizatat, duke sugjeruar mbështetje institucionale. Nga ana tjetër, komuniteti rom duket se është më i gatshëm të përballlet drejtpërdrejt me sulmuesit, duke nxjerrë në pah një mekanizëm të ndryshëm menaxhimi që mund të pasqyrojë dinamikën dhe përvojat e komunitetit të tyre. Analiza të mëtejshme mund të eksplorojnë implikimet e këtyre përgjigjeve të ndryshme dhe efektivitetin e tyre në adresimin e gjuhës së urrejtjes në internet.**

Figura 46. Në rast se keni qenë të ekspozuar ndaj gjuhës së urrejtjes në internet, çfarë keni bërë? Përgjigje të mostrës shtesë të komuniteteve LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian



### 3.5 NIVELI I NDËRGJEGJËSIMIT DHE BESIMIT NË INSTITUCIONE

Të anketuarit në mostrën e publikut të gjerë u pyetën nëse ishin në dijeni të ndonjë ligji në vend që mbron individët nga gjuha e urrejtjes. Rezultatet tregojnë se vetëm 12% e të anketuarve ishin në dijeni të këtij ligji. Përafërsisht 45% kishin dijeni për ligje të caktuara, por jo për detaje specifike, ndërsa rreth 44% nuk kishin aspak dijeni për ndonjë legjislacion përkatës. Krahasuar me vitin 2021, **ndërgjegjësimi është rritur në përgjithësi**; 57% e të anketuarve tani kanë dijeni për këto ligje, nga 41% në anketën e mëparshme.


Figura 47. A keni dijeni për ndonjë ligj që mbron njerëzit nga Gjuha e Urrejtjes? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë



Rezultatet sipas grupmoshës tregojnë se **më të rinjtë kanë më shumë dijeni për ligjet që mbrojnë nga gjuha e urrejtjes** krahasuar me grupmoshat më të vjetra, me 67% të të anketuarve të moshës 18-29 vjeç të vetëdijshëm, krahasuar me 59% të atyre të moshës 30-49 vjeç dhe 47% të atyre mbi 50 vjeç.


Gjetjet gjithashtu tregojnë dallimet gjinore, me burrat pak më të vetëdijshëm se gratë; në përgjithësi, 61% e burrave treguan një nivel të caktuar dijenie, ndërsa vetëm 50% e grave raportuan të njëjtën gjë.

Figura 48. A keni dijeni për ndonjë ligj që mbron njerëzit nga Gjuha e Urrejtjes? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas grupmoshës



Kur u pyetën për një skenar hipotetik ku do të ishin objekt i gjuhës së urrejtjes, të anketuarit treguan se do të kërkonin kryesisht ndihmë nga familja ose miqtë. Megjithatë, kjo mbështetje të lidhjet personale ishte më e theksuar në anketën e vitit 2021. **Në anketën aktuale, duket se ka një zhvendosje të lehtë drejt vendosjes së besimit tek institucionet ose individët e tjerë, siç janë policia ose Komisioneri kundër diskriminimit, megjithëse familja mbetet zgjedhja e parë.** Mundësi të tjera, të tilla si kontakti me një avokat të popullit, shoqëri të civile, avokatët ose median, u përmendën më rrallë, ku një në dhjetë ose më pak i konsideruan këto alternativa.

Figura 49. Nëse do të ishit objekt i gjuhës së urrejtjes, ku do të shkonit për të kërkuar ndihmë? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë



**Rezultatet tregojnë dallime të dukshme në nivelet e besimit mes gjinive** në lidhje me individë dhe institucione të ndryshme. Edhe pse ka pak ndryshime në besimin e vendosur te familja dhe miqtë, **shfaqen dallime të konsiderueshme kur bëhet fjalë për besimin te Komisioneri kundër Diskriminimit, mjekët, psikologët dhe organizatat e shoqërisë civile.** Gratë tregojnë nivele besimi dukshëm më të larta duke kërkuar ndihmë nga këto burime nëse bëhen shënjestër e gjuhës së urrejtjes, krahasuar me burrat.

**Ky ndryshim tregon nevojën për një fokus më të madh te burrat, pasi tendenca e tyre për të heshtur për këto çështje mund të rezultojë në sfida shtesë. Promovimi i dialogut të hapur dhe ofrimi i mbështetjes së synuar për burrat mund të ndihmojë në adresimin e këtyre shqetësimeve në mënyrë më efektive.** Kjo tendencë u vu re edhe në anketën e vitit 2021, duke sugjeruar që iniciativat e zbatuara gjatë kësaj periudhe nuk kanë ndikuar ndjeshëm në gatishmërinë e burrave për të kërkuar ndihmë.

Figura 50. Nëse do të ishit objekt i gjuhës së urrejtjes, ku do të shkonit për të kërkuar ndihmë? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas seksit.




Figura 51. Nëse do të ishit objekt i gjuhës së urrejtjes, ku do të shkonit për të kërkuar ndihmë? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas seksit



Rezultatet sipas moshës tregojnë dallime të rëndësishme në burimet e mbështetjes të zgjedhura nga të anketuarit:

- **Miqtë ose familja** zgjidhen nga një në dy të anketuar të moshës së re dhe të moshuar, por zgjidhen më pak (një e treta) në grupin e mesëm 30-49 vjeç.
- **Komisioneri kundër Diskriminimit** zgjidhet nga pothuajse një në katër të anketuar të grupmoshave 18-29 dhe 30-49 vjeç, ndërsa vetëm 9% e atyre mbi 50 vjeç zgjedhin këtë opsion.
- **Për mjekët dhe psikologët**, 25% e grupit më të ri zgjedhin këtë opsion, krahasuar me 18% të atyre të moshës 30-49 vjeç dhe vetëm 16% të të anketuarve mbi 50 vjeç.
- Lidhur me **avokatët e popullit**, 10% e të anketuarve të moshës 18-29 vjeç zgjedhin këtë burim, njësoj si 16% e atyre në grupmoshën 30-49 vjeç dhe vetëm 8% e të anketuarve mbi 50 vjeç.
- Moshë më e vjetër **nuk do të shkonte të fliste me dikë** (19% kundrejt 6% dhe 8% të përmendur nga grupet më të reja).
- **Organizatave shoqërisë civile** duket se kanë më shumë besimin e të anketuarve më të rinj se të atyre më të vjetër.

Këto gjetje nxjerrin në pah nivelet e ndryshme të besimit dhe gatishmërisë për të kërkuar ndihmë në grupmoshat e ndryshme.

Pyetësi vijon më tej përpjekjen për të eksploruar arsyet pse njerëzit do të hezitonin të kërkonin ndihmë. Rezultatet tregojnë se shumica e të anketuarve (nga 97 persona gjithsej) mendojnë se askush nuk do të interesohej nëse ata do të kërkonin ndihmë. Rreth 26% mendojnë se askush nuk do t'i besonte dhe 15% të tjerë kanë frikë se nuk do të merren seriozisht. Arsyet e tjera të përmendura janë se ata ndiejnë se nuk do të gjejnë asnjë zgjidhje ose preferojnë të gjejnë vetë një zgjidhje tjetër.

Figura 52 Mund të shpjegoni pse? (vetëm ata që nuk do të shkonin të kërkonin ndihmë), Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas seksit.



Rezultatet sipas gjinisë tregojnë se një përqindje më e lartë e grave kanë frikë se askush nuk do të interesohet vërtet (85% krahasuar me 60% të burrave). Përveç kësaj, një numër më i madh i burrave shprehin shqetësimin që askush nuk do t'i besonte, 29% e burrave krahasuar me 17% të grave.

Në fund të anketës, të anketuarve iu kërkua **mendimi i tyre se cilat institucione besojnë se janë më të përkushtuara për të luftuar gjuhën e urrejtjes në vend. Kjo pyetje mat në mënyrë indirekte besimin e publikut në këto institucione për të adresuar këto çështje.**

**Shkollat dhe universitetet, së bashku me organizatat e shoqërisë civile dhe subjektet ndërkombëtare, shihen si më të përkushtuara për të luftuar gjuhën e urrejtjes.** Megjithatë, ka pasur një rënie të dukshme në perceptimin e institucioneve fetare, me mbështetje që ka rënë nga 39% në vitin 2021 në 24% në vitin 2024. Po njësoj, besimi në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe në Ministrinë e Ekonomisë ka rënë përkatësisht nga 31% në vitin 2021 në 21% në vitin 2024 dhe nga 21% në vetëm 7% në vitin 2024. Ka disa dallime sipas gjinisë; gratë kanë më shumë besim tek organizatat ndërkombëtare se burrat (36% kundrejt 24%), gjithashtu gratë kanë më shumë besim te Komisioneri kundër diskriminimit (30% kundrejt 13%). Dallime të tjera shihen edhe në grafikun më poshtë sipas gjinisë.

Figura 53. Për mendimin tuaj, cilat janë institucionet më të përkushtuara për të luftuar gjuhën e urrejtjes në Shqipëri. Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë





Figura 54. Për mendimin tuaj, cilat janë institucionet më të përkushtuara për të luftuar gjuhën e urrejtjes në Shqipëri, Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë të ndarë sipas seksit.



Ne pyetëm për shpreshtinë e gjuhës së urrejtjes në forumet publike (si media sociale dhe lajme) dhe se si ka ndryshuar ajo gjatë pesë viteve të fundit. Rezultatet tregojnë se 70% e të anketuarve besojnë se është rritur (disi ose ndjeshëm). Megjithatë, gjysma e të anketuarve nuk shprehin një mendim mbi efektivitetin e masave aktuale (si udhëzimet dhe ligjet e komunitetit) në uljen e gjuhës së urrejtjes krahasuar me pesë vite më parë.

Figura 55 Për mendimin tuaj, si ka ndryshuar shpreshtia e gjuhës së urrejtjes në forume publike (p.sh., media sociale, lajme) gjatë pesë viteve të fundit? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë






Figura 56 Si ndiheni për efektshmërinë e masave aktuale (p.sh., udhëzime komuniteti, ligje) në uljen e gjuhës së urrejtjes krahasuar me disa vite më parë? Përgjigje e mostrës së publikut të gjerë



### 3.5 NIVELI I NDËRGJEGJËSIMIT DHE BESIMIT TË MOSTRËS SHITESË NË INSTITUCIONE

Një nga pyetjet kryesore që iu drejtuan të anketuarve të komuniteteve LGBTI+ dhe rom/egjiptian ishte ndërgjegjësimi i tyre për ligjet që mbrojnë individët nga gjuha e urrejtjes. **Veçanërisht, komuniteti LGBTI+ tregoi një ndërgjegjësim më të madh për këto mbrojtje krahasuar me komunitetin rom.** Përafërsisht 41% e të anketuarve LGBTI+ janë të informuar mirë, ndërsa 51% janë të vetëdijshëm, por jo plotësisht të informuar; vetëm 8% nuk janë në dijeni të këtyre ligjeve. Nga ana tjetër, vetëm 17% e komunitetit rom është e mirë-informuar, 39% janë të vetëdijshëm, por jo plotësisht të informuar dhe rreth gjysma (44%) nuk janë plotësisht të vetëdijshëm për këto ligje mbrojtëse. Kjo mospërputhje mund të lidhet me nivelet më të ulëta të arsimit brenda komunitetit rom.

Figura 57. A keni dijeni për ndonjë ligj që mbron njerëzit nga Gjuha e Urrejtjes? Përgjigje të mostrës shtesë të komuniteteve LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian




Anketa prezantoi tregues shtesë për të matur besimin në institucione të ndryshme të specializuara që ndihmojnë individët e prekur nga gjuha e urrejtjes. Për **komunitetin LGBTI+, burimet kryesore të mbështetjes janë organizatat e shoqërisë civile (41%) dhe Komisioneri kundër Diskriminimit (40%).** Në anën tjetër, **anëtarët e komunitetit rom kanë më shumë gjasa t'u drejtohen për ndihmë oficerëve të policisë (38%)** ose Komisionerit kundër Diskriminimit (29%).

Është interesante që komuniteti **LGBTI+ e rendit policinë si institucionin e katërt më të besuar për denoncimin e gjuhës së urrejtjes, ndërsa komuniteti rom e vendos atë në krye.** Kjo nxjerr në pah një ndryshim të rëndësishëm në perceptim në lidhje me mbështetjen e policisë. Për më tepër, besimi në organizatat e **shoqërisë civile** është dukshëm më i ulët mes komunitetit rom, me vetëm 16% që i konsiderojnë ato një burim të besueshëm, krahasuar me 41% të komunitetit LGBTI+ që i shohin ato si opsionin e tyre kryesor.

**Avokatët** gjithashtu duket se kanë një nivel më të madh besimi brenda komunitetit rom (17%) se brenda komunitetit LGBTI+ (7%). Miqtë dhe familja renditen si tre burimet kryesore të mbështetjes për të dy komunitetet, me 34% të të anketuarve LGBTI+ dhe 31% të të anketuarve rom që tregojnë se do t'u drejtoreshin atyre për ndihmë. Nuk ka dallime të konsiderueshme mes dy komuniteteve në lidhje me besimin në institucione të tjera, siç janë avokatët, zyrat publike ose gjykatat. Kjo analizë tregon se, ndërsa


të dy komunitetet kërkojnë mbështetje nga burime të ngjashme, preferencat dhe nivelet e tyre të besimit ndryshojnë ndjeshëm, veçanërisht në lidhje me shoqërinë civile dhe agjencitë e zbatimit të ligjit.

Figura 58. Nëse do të ishit objekt i gjuhës së urrejtjes, ku do të shkonit për të kërkuar ndihmë? Përgjigje të mostrës shtesë të komuniteteve LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian



Për të kuptuar pse shumë individë zgjedhin të mos kërkojnë ndihmë ose të mos flasin me askënd, të anketuarve iu drejtua një pyetje specifike. Një numër i konsiderueshëm shprehën ndjenja indiference nga të tjerët. **Anëtarët e komunitetit LGBTI+ shpesh shqetësohen se nuk do të merren seriozisht ose kanë frikë nga viktimizimi i mëtejshëm.** Ndërkohë, **komuniteti rom jo vetëm që ndan shqetësime për indiferencën, por gjithashtu beson se të tjerët mund të mos i besojnë ose mund të mos e konsiderojnë gjuhën e urrejtjes si një çështje serioze.**

Figura 59. Mund të shpjegoni pse? (vetëm ata që nuk do të shkonin të kërkonin ndihmë), Përgjigje të mostrës shtesë të komuniteteve LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian




Në fund, nga përgjigjet e tyre mund të nxirret një vlerësim i ndërgjegjësimit të tyre për institucionet që janë më të përkushtuara ndaj luftës kundër gjuhës së urrejtjes në Shqipëri. Institucionet që konsiderohen më të përkushtuara për adresimin e gjuhës së urrejtjes kundër komunitetit LGBTI+ përfshijnë:

- Organizatat ndërkombëtare: 66%
- Shoqatat/shoqërinë civile: 50%
- Komisionerin kundër Diskriminimit: 38%

Nga ana tjetër, për komunitetin rom, institucionet e identifikuara janë:

- Shkolla/universitete: 25%
- Komisioneri kundër Diskriminimit: 24%
- Avokati i popullit: 23%

Figura 60. Për mendimin tuaj, cilat janë institucionet më të përkushtuara për të luftuar gjuhën e urrejtjes në Shqipëri? Përgjigje të mostrës shtesë të komuniteteve LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian



Studimi përfshinte gjithashtu pyetje për perceptimet e shpeshsisë së gjuhës së urrejtjes në forumet publike, siç janë media sociale dhe lajmet, gjatë pesë viteve të fundit. **Përafërsisht 75% e të anketuarve nga komuniteti LGBTI+ besojnë se gjuha e urrejtjes është rritur** (disi ose ndjeshëm), **ndërsa këtë pikëpamje e ndan vetëm 41% e komunitetit rom.**

Gjithashtu, ne u kërkuan pjesëmarrësve të vlerësonin efektivitetin e udhëzimeve dhe ligjeve aktuale të komunitetit në uljen e gjuhës së urrejtjes krahasuar me pesë vite më parë. **Mes komunitetit LGBTI+, rreth një në tre të anketuar mendojnë se këto masa janë më pak efektive**, ndërsa 30% i konsiderojnë ato efektive. **Përkundrazi, komuniteti rom ka një pikëpamje më pozitive, me vetëm 10% që besojnë se masat janë më pak efektive dhe 44% që i shohin ato si efektive.**

Figura 61 Për mendimin tuaj, si ka ndryshuar shpeshësia e gjuhës së urrejtjes në forume publike (p.sh., media sociale, lajme) gjatë pesë viteve të fundit? Përgjigje të mostrës shtesë të komuniteteve LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian





Figura 62 Si ndiheni për efektshmërinë e masave aktuale (p.sh., udhëzime komuniteti, ligje) në uljen e gjuhës së urrejtjes krahasuar me disa vite më parë? Përgjigje të mostrës shtesë të komuniteteve LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian



## 4. Lista e Anekseve

### 4.1 FJALORTH

**Poshtërim për shkak të pamjes fizike:** akti i talljes ose përqeshjes së pamjes fizike të një personi. Objekti i poshtërimit për shkak të pamjes fizike është i gjerë dhe mund të përfshijë, edhe pse jo vetëm, **poshtërim për shëndetin e tepërt**, poshtërim për të qenit i dobët, poshtërim për gjatësinë, poshtërim për qimet në trup (ose për mungesën e tyre), për ngjyrën e flokëve, formën e trupit, muskujt (ose për mungesën e tyre), poshtërim për pamjen (tiparet e fytyrës) dhe në kuptimin e vet më të gjerë mund të përfshijë edhe poshtërimin për tatuazhe dhe shpime në lëkurë apo për sëmundje që lënë gjurmë fizike, siç është psoriaza. Ndonjëherë, poshtërimi për shkak të pamjes fizike mund të shtrihet deri në perceptimin se dikush nuk shfaq mjaftueshëm tipare mashkullore ose femërore. Për shembull, burrat me ije të gjera ose gjoks të dukshëm ose mungesë të qimeve të fytyrës ndonjëherë poshtërohen sikur kanë pamje femërore. Po njësoj, gratë poshtërohen për shkak të mungesës së feminitetit të tyre, se duket që kanë fryrje mashkullore apo shpatulla të gjera, tipare që lidhen zakonisht me burrat. Poshtërimi për shkak të pamjes fizike në nivele të ekzagjeruara mund të ketë efekte negative emocionale, përfshirë ulje të vetëvlerësimit dhe çështje të tjera të tilla si çrregullimet të të ngrënit, ankth, dismorfia trupore dhe depresion. Gjithashtu, poshtërimi për shkak të pamjes fizike mund të çojë në depresion të rëndë, sidomos kur njerëzit mendojnë se trupi i tyre nuk i përmbush kriteret shoqërore.

**Kërcënim me vdekje:** kërcënimi me vdekje është kërcënim, i bërë shpesh në mënyrë anonime, nga një person ose një grup njerëzish për të vrarë një person tjetër ose një grup njerëzish. Këto lloj kërcënimesh shpesh bëhen për t'i frikësuar viktimat, për t'i penguar ose manipuluar sjelljen e tyre, dhe prandaj kërcënim i me vdekje mund të jetë një formë e shtrëngimit. Për shembull, kërcënim i me vdekje mund të përdoret për ta penguar një figurë publike që të mos kryejë një hetim penal apo një fushatë mbrojtëse.

**Shpifje:** njihet edhe si **trillim**, stisje, **sajesë**, **përfolje**, akuza të rreme apo lëndim, është komunikimi me gojë ose me shkrim i një deklaratë të rremë për një person apo grup tjetër që në mënyrë të padrejtë cenon reputacionin e tyre dhe zakonisht përbën shkelje ose krim. Disa juridiksione të së drejtës zakonore bëjnë dallimin ndërmjet **shpifjes së folur**, të **quajtur përfolje** dhe shpifjes në mënyra të tjera, si me shkrim apo me pamje, të quajtur shpifje me shkrim. Në disa juridiksione, shpifja trajtohet edhe si krim.

**Dehumanizim:** mohimi i humanizimit të plotë të të tjerët dhe mizoria dhe vuajtja që e shoqërojnë atë. Më gjerësisht, t'i shikosh dhe trajtosh personat e tjerë sikur u mungon aftësia mendore që zakonisht u atribuohet qenieve njerëzore. Dehumanizimi është gjithashtu një 'teknikë' në nxitjen e gjenocidit dhe është përdorur për të justifikuar luftën, vrasjet gjyqësore dhe jashtëgjyqësore, skllavërinë, konfiskimin e pasurisë, mohimin e votës dhe të drejtat e tjera dhe për të sulmuar armiqet ose kundërshtarët politikë.

**Denigrim:** sulmi ndaj aftësisë, karakterit apo reputacionit të një apo më shumë personave në lidhje me përkatësinë e tyre me një grup të caktuar personash.

**Diskriminim:**<sup>17</sup> çdo trajtim i ndryshëm për shkaqe si "raca", ngjyra, gjuha, feja, kombësia ose origjina kombëtare ose etnike, si dhe prejardhja, besimi, seksi, gjinia, identiteti gjinor, orientimi seksual ose karakteristika të tjera personale ose statusi, që nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

**Shaka mbi baza etnike:** një koment që synon të krijojë humor lidhur me një grup etnik, racor ose kulturor, shpesh duke iu referuar një stereotipi etnik të grupit në fjalë kur jep thelbin e shprehjes. Perceptimet e shakave me baza etnike janë ambivalente: teksa shumë i konsiderojnë ato raciste dhe fyese (dhe madje edhe si thirrje për dhunë), disa njerëz i konsiderojnë ato të pranueshme, brenda fushës së humorit. Sidoqoftë, shumica e studiuesve pretendojnë se shakatë mbi baza etnike mund të përforcojnë stereotipet etnike dhe të kenë efekte të rënda psikologjike tek objektivi i tyre.

17 Fjalorthi ECRI- Komisioni Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI)

**Gjini:**<sup>18</sup> do të thotë role, sjellje, aktivitete dhe tipare të krijuara nga shoqëria, që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për gratë dhe burrat.

**Identitet gjinor:**<sup>19</sup> i referohet përvojës së brendshme dhe individuale të çdo personi për gjininë, e cila mund ose mund të mos i korrespondojë seksit të caktuar në lindje, duke përfshirë ndjesinë personale të trupit (e cila mund të përfshijë, nëse zgjidhet lirisht, modifikimin e paraqitjes ose funksionimit të trupit me rrugë mjekësore, kirurgjikale ose të tjera) dhe shprehje të gjinisë, përfshirë veshjen, të folurën dhe manierizmat.

**Gjuhë e urrejtjes:**<sup>20</sup> është avokimi, promovimi, ose nxitja, në çdo formë, e denigrimit, urrejtjes, apo poshtëritimit të një personi apo grupi të personave, si dhe ngacmimi, fyerja, stereotipizimi negativ, stigmatizimi apo kërcënim i ndaj këtij personi apo personave dhe justifikimi i të gjitha këtyre formave të të shprehurit për shkak të “racës”, ngjyrës, prejardhjes, origjinës kombëtare ose etnike, moshës, aftësisë së kufizuar, gjuhës, fesë ose besimit, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual dhe karakteristikave të tjera personale apo statusit; mund të jetë në formën e mohimit publik, uljes së rëndësisë, justifikimit ose shfajësimit të krimeve të genocidit, krimeve kundër njerëzimit, ose krimeve të luftës që gjykatat kanë konstatuar se kanë ndodhur, si edhe glorifikimin e personave që i kanë kryer këto krime. (§§ 5 deri në 6 i Preambulës së GPR. 15). Në këtë kontekst, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës në Rekomandimin e tij CM/Rec(2022)16 për luftën kundër gjuhës së urrejtjes përkufizon “gjuhën e urrejtjes” si “të gjitha llojet e shprehjeve që nxisin, promovojnë, përhapin ose justifikojnë dhunën, urrejtjen ose diskriminimin ndaj një personi ose grupi personash, ose që i denigron ata, për shkak të karakteristikave personale reale ose të atribuara ose statusit të tyre, siç janë ‘raca’, ngjyra, gjuha, feja, kombësia, origjina kombëtare ose etnike, mosha, aftësia e kufizuar, seksi, identiteti gjinor dhe orientimi seksual.

**Urrejtje:** është gjendje shpirtërore e karakterizuar si emocione të forta dhe irracionale të përbuzjes, armiqësisë dhe neveritjes ndaj grupit të synuar.

**Homofobi:** është paragjykim kundër, urrejtje ndaj, ose frikë nga homoseksualiteti ose nga njerëzit që identifikohen ose perceptohen se janë biseksualë, gej, lesbike ose transgjinorë.

**Nxitje:** deklaratat për grupe të personave që krijojnë rrezik të afërt për diskriminim, armiqësi ose dhunë ndaj personave që u përkasin atyre grupeve.

**Islamofobi:** është paragjykimi, urrejtja ndaj ose frika nga feja Islame ose myslimanët.

**Stereotipizimi negativ:** atribuimi ndaj një anëtari ose ndaj anëtarëve të një grupi personash i një besim të përgjithësuar në lidhje me karakteristikat e atyre që i përkasin atij grupi që përfshin shikimin e të gjithë atyre me sy negativ, pavarësisht nga karakteristikat e veçanta të anëtarit ose anëtarëve të veçantë në fjalë.

**Racizëm:**<sup>21</sup> bindja se shkaqe si “raca”, ngjyra, gjuha, feja, kombësia ose origjina kombëtare ose etnike justifikojnë përbuzjen për një person ose një grup personash, ose nocionin e epërsisë së një personi ose një grupi personash.

**Orientim seksual** i referohet aftësisë së çdo personi për tërheqje të thellë emocionale, afeksioni dhe seksuale, dhe marrëdhënieve intime dhe seksuale me, individë të një gjinie të ndryshme ose të së njëjtës gjini ose më shumë se një gjini.

**Stigmatizim** është etiketimi i një grupi personash në mënyrë negative.

**Sharje: sharja racore ose etnike** është shprehje me qëllimin për të shpifur, poshtëruar, përbuzur dhe fyer pjesëtarë të një grupi racor ose etnik, zakonisht nga ata që nuk janë pjesëtarë të atij grupi racor ose etnik. Në anglisht, shembuj të sharjeve racore ose etnike përfshijnë shprehje si “negro,” “kun” dhe “kajk”.

**Transfobi:** paragjykim ndaj, urrejtje kundër apo frikë nga transseksualiteti dhe personat transseksualë ose transgjinorë, bazuar në shprehjen e identitetit të tyre gjinor të brendshëm.

18 Fjalorthi ECRI- Komisioni European kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI)

19 Fjalorthi ECRI- Komisioni European kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI)

20 Fjalorthi ECRI- Komisioni European kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI)

21 Fjalorthi ECRI- Komisioni European kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI)

**Abuzim verbal:** edhe, sulm verbal apo **mësymje verbale**, është akti i kritikës, fyerjes apo denoncimit me forcë të një personi tjetër. Karakterizohet nga zemërimi dhe urrejtja e fshehur, është një formë shkatërruese e komunikimit që synon të dëmtojë konceptin e personit tjetër për veten dhe të krijojë emocione negative. Abuzimi verbal është mekanizëm i keqpërshtatur që secili mund ta shfaqë herë pas here apo në kohë të stresit apo paretisë së madhe fizike. Për disa njerëz, është model i sjelljes që përdoret me qëllim për të kontrolluar ose manipuluar të tjerët, ose për t'u hakmarrë.

**Poshtërim:** kritika abuzive e një apo më shumë personave në lidhje me përkatësinë e tyre në një grup të caktuar personash.

**Dhunë:** përdorimi i forcës fizike ose fuqisë kundër një personi tjetër, ose kundër një grupi ose komuniteti, që rezulton ose ka gjasë të lartë të rezultojë në, lëndim, vdekje, dëmtim psikologjik, keqzhvillim ose privim. Në fushën e gjuhës së urrejtjes dhe luftës kundër gjuhës së urrejtjes, sidoqoftë, dhuna synohet të jetë edhe **psikologjike**, d.m.th. është veprimi i qëllimshëm kundër një personi ose një grupi njerëzish që sjell dëmtime fizike, mendore, shpirtërore, morale dhe shoqërore, përfshirë fyerje, kërcënime, sulme, abuzim verbal.

**Grupe të cënueshme:** ato grupe që janë posaçërisht objekt i gjuhës së urrejtjes, që ndryshojnë në varësi të rrethanave kombëtare, por ka të ngjarë të përfshijnë azilkërkues dhe refugjatë, emigrantë dhe migrantë të tjerë, komunitete të të zinjeve dhe hebrenjeve, myslimanë, romë/ciganë, si dhe pakica të tjera fetare, historike, etnike dhe gjuhësore dhe personat LGBT; në veçanti përfshin fëmijë dhe të rinj që i përkasin këtyre grupeve.

**Ksenofobia:** përkufizohet si frika ose urrejtja ndaj asaj që perceptohet të jetë e huaj ose e panjohur. Është shprehje e konfliktit (të perceptuar dhe të pavetëdijshëm) ndërmjet një grupi të brendshëm dhe një grupi të jashtëm dhe mund të shfaqet si dyshim ndaj njëri-tjetrit, si dëshirë për të marginalizuar, heshtur, ose eliminuar praninë e grupit të jashtëm dhe frikën e humbjes së identitetit kombëtar, etnik ose racor.

## 4.2 ANEKSI II: PYETËSOR

### GJUHA E URREJTJES DHE DISKRIMINIMI NË SHQIPËRI

This survey deals with hate speech and discrimination in Albania.

The survey aims to assess and increase the awareness of hate speech in society. Its results will be used to support and implement actions for combating hate speech and hate speech effects.

For this reason, we would be very grateful if you could fill in the questionnaire which will provide us your views on the topic.

The questionnaire is anonymous.

Thank you for your cooperation.

#### Informacion bazë (B)

B1: Seksi/Gjinia

1. Mashkull
2. Femër
3. Preferoj të vetë-përshkruhem si \_\_ (jobinar, gjini e papërcaktuar, pagjini, lutemi specifikoni)
4. Preferoj të mos e them

B2: Moshë

\_\_\_\_\_ (i anketuari e plotëson moshën e vet)

B3: Shtetësia/Grupi etnik

1. Malazez
2. Serb
3. Shqiptar
4. Boshnjak
5. Grek
6. Bullgar
7. Rom
8. Egjiptian
9. Arumun
10. Maqedonas i Veriut
11. Tjetër (ju lutemi të specifikoni) \_\_\_\_\_

B4: Niveli arsimor i përfunduar

1. Pa arsim
2. Shkolla e mesme – cikli i parë
3. Shkolla e mesme – cikli i dytë
4. Universiteti - parauniversitar/diplomim
5. Universiteti – pasuniversitar (Master, Ph.D.)

B5: A jeni i punësuar në:

1. Sektor publik
2. Sektor privat
3. Të vetëpunësuar
4. Të papunë
5. Në pension

B6: Feja (vetëm një përgjigje)

1. Kisha ortodokse
2. Islame
3. Katolike
4. Kisha evangjelike
5. Bektashiane
6. Fe të tjera
7. Pa orientim fetar

8. Preferoj të mos e them

*Vetëm për pyetësin e synuar ():*

**Si do ta përkufizonit veten?**

1. Heteroseksual
2. Lezbike
3. Homoseksual

4. Vajzë/grua biseksuale
5. Vajzë/grua transgjimore
6. Djalë/burrë transgjimor
7. Interseks
8. Tjetër, specifikoni

**A jeni person me aftësi të kufizuara?**

1. Po
2. Jo

Informacion në lidhje me gjuhën e urrejtjes (GJU)

GJU1: A e dini çfarë është gjuha e urrejtjes?

1. Po
2. Jo
3. Nuk e di/Nuk jam i/e sigurt

GJU1.1 A e dini çfarë është gjuha ofenduese/diskriminuese?

*Për shembull, përdorimi i fjalëve specifike që ofendojnë personat për shkak të orientimi seksual, karakteristikave fizike etj.*

1. Po
2. Jo - Fundi i pyetësorit

GJU2: Nëse jeni përgjigjur me 'po' në pyetjen paraprake, a mund të shpjegoni me disa fjalë çfarë do të thotë kjo për ju?

GJU3: Për mendimin tuaj, sa e përhapur është gjuha e urrejtjes në Shqipëri?

1. Në masë të vogël
2. Në një farë mase
3. Në masë të moderuar
4. Në masë të gjerë
5. Në masë shumë të gjerë
6. Nuk jam i/e sigurt

GJU4: Për mendimin tuaj, cili është motivi më i zakonshëm që shkakton Gjuhën e Urrejtjes (mund të zgjidhni më shumë se një motiv)

1. Homo-bi-lesbo-transfobia (*Fobia/frika nga komuniteti LGTB*)
2. Mizogjinia (*Fobia/frika nga gratë*)
3. Paraqitja fizike
4. Kombësia (kundër kombësive të tjera)
5. Etnia (kundër pakicave etnike, si romë, egjiptianë etj.)
6. Ksenofobia (kundër të huajve, emigrantëve, refugjatëve)
7. Raca

8. Feja
9. Opinioni politik
10. Statusi shoqëror
11. Varfëria/mungesa e strehimit
12. Urrejtja kundër OJQ-ve, vullnetarëve, mbrojtësve të të drejtave të njeriut
13. Moshë
14. Aftësia e kufizuar
15. Të gjitha
16. Tjetër (ju lutemi të specifikoni) \_\_\_\_\_

GJU5: Për mendimin tuaj, ku/në cilin kontekst mund të përjetohet më shumë Gjuha e Urrejtjes në Shqipëri (mund të zgjidhni më shumë se një motiv)?

1. Vende pune
2. Shkolla/universitete
3. Sport
4. Zyra publike
5. Sektor i shëndetit
6. Transporti
7. Media tradicionale, siç janë gazetat, TV, radio etj.
8. Media sociale
9. Platforma për transmetim siç janë Zoom, Meet, Teams etj
10. Ligjërimi politik
11. Biseda private
12. Tjetër (ju lutemi të specifikoni) \_\_\_\_\_

